



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri
Gjeomjedisi”**

ofruar nga

Universiteti Politeknik i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Genti Kromidha

Dr. Stela Sefa

Janar/ 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Inxhinieri Gjeomjedisi"**

1	IAL aplikues:	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Tokës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Inxhinieri Gjeomjedisi"
4	Urdhri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 243, datë 14.06.2012
5	Urdhri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër i QSHA Nr. 152, datë 16.04.2021
7	Urdhri/VBA i akreditimit të parë:	Programi akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 (tre) vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Për vitet akademike: 2023-2024 47 PAE/ 1 PAK 2022-2023 53 PAE/ 1 PAK 2021-2022 60 PAE/ 4 PAK
18	Numri i studentëve:	Të regjistruar për herë të parë në vitin e parë: Viti akademik 2021-2022 –22 studentë Viti akademik 2022-2023 –15 studentë Viti akademik 2023-2024 – 9 studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit në proces të akreditimit për herë të parë të tij, Bachelor në "Inxhinieri Gjeomjedisi" është hapur me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (UMASH) Nr. 243, datë 14.06.2012 "Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave të Universitetit Politeknik të Tiranës"

Programi i Studimit ofrohet pranë Departamentit të Shkencave të Tokës, Fakulteti i Gjeologji Minierave.

I gjithë Raporti i Vlerësimit të Jashtëm të këtij programi është përqendruar në Dosjen e Vetëvlerësimit të dorëzuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të këtij programi, në vizitën në Institucion dhe në takimet që kemi realizuar si Grup Vlerësimi. Në këtë Raport janë pasqyruar të dhënat që kanë dalë si rezultat i punës dhe i analizës së GVJ mbi procesin e vlerësimit të jashtëm.

Programi i studimit i përket ciklit të parë të studimeve Bachelor, nivelit 6 (gjashtë) në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, ofrohet në gjuhën shqipe, me një total prej 180 ECTS dhe zgjat 3 vite akademike.

Sipas të dhënave të paraqitura nga Institucioni në dosjen e vetëvlerësimit (numri rendor i dokumenteve 117, materiali në pdf), në këtë program studimi japin mësim gjithsej 41 personel akademik (PA), nga të cilët:

21 janë PAE (7 Prof. Dr; 3 Prof. Asoc; 6 Dr; 5 Msc)

20 janë PAK (1 Prof. Dr.; 6 Prof. Asoc.; 9 Dr; 4 Msc)

Referuar tabelës me të dhënat për këtë program studimi (tabela 6.1) rezulton se në këtë vit akademik (2023-2024) personeli akademik i këtij programi studimi të jetë në total 47 PAE/ 1PAK.

Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (pranime) në programin e studimit BSc në "Inxhinieri Gjeomjedisi", referuar Tabelës 21 të të dhënave për këtë program studimi, dhe të dhënave të marra në Sekretarinë mësimore, është si më poshtë:

Viti akademik	referuar Tabelës 21	Sipas të dhënave të marra në Sekretarinë mësimore	
	Regjistruar	Regjistruar	Çregjistruar
2021 – 2022	22 studentë	28 studentë	3 studentë
2022 – 2023	15 studentë	15 studentë	1 student
2023 – 2024	9 studentë	9 studentë	

Referuar tabelës Nr. 23, ku paraqiten të dhënat për studentët e diplomuar, rezulton se për periudhën 2022-2024 numri total i të diplomuarve është 68 studentë.

Sipas të dhënave në Sekretarinë mësimore, në vitin 2022 janë 20 studentë të diplomuar, ndërsa në vitin 2023 janë 25 studentë të diplomuar.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Grupi i vlerësuesve të jashtëm për këtë program studimi përbëhet nga Dr. Genti Kromidha dhe Dr. Stela Sefa. Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë program studimi është Msc. Rajna Lila

GVJ mori në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e përcjellë nga IAL si pjesë të Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV) dhe vendosi realizimin e vizitës në Institucion më datë 28 Qershor dhe 1 Korrik 2024, për të cilën u hartua edhe Agjenda e vizitës me takimet përkatëse.

Në bazë të Agjendës, GVJ realizoi në Universitetin Politeknik të Tiranë takime me:

- Dekanin e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave
- Përgjegjës të Departamentit të Shkencave të Tokës
- Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, të përbërë nga 5 anëtarë
- Përfaqësues të personelit të angazhuar në program
- Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- Drejtorinë e kërkimit shkencor dhe projekteve
- Drejtorinë e Kurikulave
- Studentët e programit BSc në "Inxhinieri Gjeomjedisi"

Gjithashtu GVJ realizoi një vëzhgim të mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.). Gjatë vizitës u vërejt që për shkak të rikonstruksionit të godinës së fakultetit, një pjesë e laboratorëve në shërbim të programit të studimit, nuk ishin funksionale. Po kështu, edhe biblioteka e Fakultetit nuk ishte funksionale për shkak të rikonstruksionit.

Mbi bazën e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV), informacionit të marrë gjatë takimeve të realizuara në Institucion, GVJ ka hartuar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ).

Universiteti Politeknik i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 19.12.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 38 / 62 Prot, datë 19.12.2024. Universiteti Politeknik i Tiranës, njofton në ASCAL më datë 06.01.2025, me anë të shkresës me Nr.03 Prot, datë 06.01.2025 "Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 03 Prot, Datë 06.01.2025.

Përgjigje e GVJ në lidhje me shkresën e dërguar nga UPT për Draft Raportin e vlerësimit të jashtëm për programin në proces akreditimi, Bachelor në "Inxhinieri Gjeomjedisi".

Grupi i vlerësimit të jashtëm, pasi u njoh nga Koordinatorja e ASCAL, me shkresën e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave me Nr. 03 Prot., datë 06.01.2025 me lëndë "Sqarime të mëtejshme lidhur me njoftimin e ASCAL për dërgimin e Raportit të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të



programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Gjeomjedisi", pa me kujdes pikat për të cilat ka dhënë përgjigje Institucioni në lidhje me Draft RVJ.

Për standardet e listuara në këtë shkresë, japim këto përgjigje:

- **Standardi I.2 – Praktikrat profesionale**

Institucioni dëshmon se *po punohet në forcimin e lidhjeve me bizneset për të shtuar praktikrat të cilat përgatitin studentët për tregun e punës dhe forcojnë lidhjen midis aftësive që fitohen gjatë programit dhe kërkesave të tregut të punës.*

GVJ përgëzon këtë fakt dhe shpreson në arritjen e lidhjeve të sa më shumë marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të praktikave të studentëve, por vlerësimi bëhet për situatën aktuale dhe jo për të ardhmen. **Për këtë pikë nuk bëhen ndryshime në Standardin I.2 në Draft RVJ.**

- **Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikrat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.**

Vlerësojmë se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në programin BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, duke përdorur metoda të ndryshme të mësimdhënies. Megjithatë, nga vizita që patëm në IAL, klasat nuk kishin projektor, kompjuter apo mjete të tjera audio vizive për ta bërë mësimin më nxitës me prezantime, apo video. Mendojmë se kjo gjë ndikon në cilësinë e mësimdhënies dhe mësim-nxënies, edhe pse niveli dhe kualifikimi i pedagogëve është i lartë (referuar CV-ve të tyre). Për të rritur cilësinë e mësimdhënies kemi rekomanduar institucionin që të pajisë profesorët me projektor apo me mjete të tjera teknologjike për të zhvilluar mësim sa më bashkëkohor, deri në përfundim të rikonstruksionit të godinës së FGJM.

GVJ vlerëson se Institucioni i arsimit të lartë garanton kryesisht procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikrat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Për këtë pikë nuk bëhen ndryshime në Standardin III.1 në Draft RVJ

- **Standardi IV.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

Institucioni dëshmon se disa laboratorë dhe biblioteka nuk janë funksionale për shkak të rikonstruksionit të godinës dhe është duke u punuar për laboratorë të përkohshëm.

GVJ konstatoi se mungesa e teknologjisë në mjediset e mësimdhënies si edhe të laboratorëve, vjen për shkak të rikonstruksionit të godinës së FGJM. Klasat dhe auditorët ku zhvillohej mësimi nuk plotësonin standardet bashkëkohore. Gjithashtu, Laboratorët nuk ishin plotësisht në funksion, ku pjesa më e madhe e pajisjeve ishin të ambalazhuara. Po kështu edhe biblioteka fizike nuk ishte në dispozicion.

GVJ vlerëson që Standardi IV.2, ku Institucioni i arsimit të lartë duhet të vendosi në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së

programit të studimit, përmbushet pjesërisht. Për këtë pikë nuk bëhen ndryshime në Standardin IV.2 në Draft RVJ.

- **Standardi IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësim nxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Institucioni dëshmon se biblioteka nuk ishte në dispozicion për shkak të rikonstruksionit të papërfunduar të godinës.

GVJ vlerëson se programi i studimit përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies. Por, mjediset mbështetëse të mësim nxënies, si biblioteka apo mjedise të tjera të posaçme, nuk mund të shfrytëzohen për shkak të rikonstruksionit të godinës së FGJM. Megjithatë, studentët mund të shfrytëzojnë Bibliotekën Qendrore të UPT-së. Kështu që vlerësojmë se ky standard përmbushet kryesisht. Për këtë pikë nuk bëhen ndryshime në Standardin IV.3 në Draft RVJ.

- **Standardi V.4 – Sekretaria mësimore**

Institucioni shprehet se: *Sekretaria mësimore punon vazhdimisht për ruajtjen e të dhënave të studentëve të Departamentit të Shkencave të Tokës. Këto të dhëna janë mjaft të sakta sepse merren nga regjistrat themeltar që nga regjistrimi i studentëve e deri në diplomimin e tyre.*

GVJ në konkluzionet e Standardit V.4 ka shkruar shprehimisht: *GVJ shprehet se UPT ruan të dhëna bazike në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit Bsc në Inxhinieri Gjeomjedisi, nga pranimi deri në diplomim si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Kjo fjali e GVJ pohon atë çka vetë Institucioni është shprehur për këtë pikë.*

GVJ i qëndron faktit që raportimet e Departamentit të Shkencave të Tokës, në lidhje me evidencat e paraqitura së bashku me Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, objekt vlerësimi të Ekspertëve të jashtëm, duhet të jenë më të plota. **Për këtë pikë nuk bëhen ndryshime në Standardin V.4 në Draft RVJ.**

- **Standardi V.6 - Zyra e karrierës**

Institucioni shprehet se – *Zyra e karrierës është funksionale dhe gjurmon studentët pas diplomimit të tyre. Në momentin e tërheqjes së diplomës, studentëve ju kërkohet informacion se ku janë të punësuar. Për të përmirësuar akoma dhe më tepër këtë aspekt, po punohet për ngritjen e shoqatës Alumni/ae të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave.*

GVJ përgëzon këtë fakt dhe shpreson në ngritjen dhe funksionimin e ALUMNI në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave por vlerësimi bëhet për situatën aktuale dhe jo për të ardhmen. **Për këtë pikë nuk bëhen ndryshime në Standardin V.6 në Draft RVJ.**

- **Standardi VI.1/VI.4 – Pjesëmarrja në vlerësimin e programit**

Institucioni shprehet se: *Po punohet në krijimin e një sistemi të rregullt funksional për vlerësimin nga studentët, përmes pyetësorëve anonimë, për të adresuar dobësitë e identifikuara në program dhe infrastrukturë.*


GVJ shpreson në ngritjen dhe funksionimin e sistemit për vlerësimin nga studentët përmes pyetësorëve, por situata aktuale është ajo e përshkruar në raport. **Për këtë pikë nuk bëhen ndryshime në standardin VI.1/VI.4 në Draft RVJ.**

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm

Dr. Genti Kromidha

Dr. Stela Sefa



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri Gjeomjedisi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Gjeomjedisi”, është program studimi që ofrohet në Departamentin e Shkencave të Tokës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Universiteti Politeknik i Tiranës. Programi i studimit është i licencuar/hapur që në vitin 2012 dhe ky është vlerësimi i parë i tij në kuadër të akreditimit. Sipas të dhënave në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV), programi ofrohet në gjuhën shqipe, me 180 ECTS, zgjat 3 vite akademike. Sipas nenit 5 të Rregullores së programit të studimit, ky program realizohet në përputhje të plotë me Statutin dhe Rregulloren mësimore të UPT, dhe Rregulloren e brendshme të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave. Që nga koha e licencimit të tij (2012) deri në vitin 2019, programi është ofruar në Departamentin e Burimeve të Energjisë. Nga viti 2019 dhe në vazhdim me vendim të Dekanatit të FGJM (Vendimi Nr. 116, datë 14.11.2019) administrimi i diplomës Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi kryhet nga Departamenti i Shkencave të Tokës. Programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe ashtu si edhe programet e tjera që ofrohen në UPT, synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. <i>Referenca:</i> <i>Ref_001 - Statuti i UPT</i> <i>Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Sipas Rregullores së programit të studimit por edhe sipas bisedave dhe takimeve të zhvilluara nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) në Institucion, programi i studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi ka qëllim final formimin e një figure profesionale të inxhinierit me kulturë shumë disiplinore dhe me koncepte profesionale zbatuese në drejtim të njohjes, parandalimit dhe mënjanimi të fenomeneve që shkaktojnë dëmtimin dhe ndotjen e gjeomjedisit, si dhe të impianteve dhe proceseve për trajtimin dhe përpunimin e mbetjeve.

	Sipas Rregullores së Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, neni 1, ky Fakultet detyrë kryesore të tij ka arsimimin e specialistëve të lartë, formimin e shkencëtarëve të rinj si dhe kryerjen e aktivitetit kërkimor shkencor në fushat e shkencave të gjeologjisë, të burimeve minerare dhe të inxhinierisë së naftës, gjeomjedisit dhe drejtimet e lidhura me to. <i>Referenca:</i> <i>Ref_010 - Rregullore PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisit</i> <i>Ref_006 - Rregullore Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Siç e kemi shprehur edhe më sipër, programi i studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisit, ofrohet pranë Departamentit të Shkencave të Tokës (DSHT). Sipas dokumentit në DVV, Strategjia e DSHT (2018-2023), Departamenti i Shkencave të Tokës është njësi unike e Arsimit të lartë Publik në Shqipëri për përgatitjen e specialistëve në fushën e mineralogjisë, petrografisë, paleontologjisë, gjeologjisë strukturore dhe rilevimit, gjeofizikës, gjeomjedisit dhe me një drejtim të ri si ai i Sedimentologjisë dhe Gjeologjisë Detare. Ky Departament synon përsosjen dhe konsolidimin e formimit akademik dhe zgjidhjen e problemeve të rëndësishme kërkimore dhe shkencore në shkallë vendi dhe rajoni. Ky Departament synon: - Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve - Të ofrojë mundësi për të përfutur nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës - Të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal - Të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri demokratike <i>Referenca:</i> <i>Ref_009 - Strategjia e DSHT (2018-2023)</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvorjen, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Sipas materialeve të sjella në Dosjen e Vetëvlerësimit, por edhe sipas takimeve që zhvilloi GVJ në Institucion, Grupi i vlerësimit të jashtëm është i bindur që Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, ka stafin e duhur akademik për ofrimin e këtij programi studimi, shumë specifik. Nga 41 personel akademik në total që japin mësim në këtë program studimi, një pjesë e konsiderueshme e tyre janë me titull dhe me gradë (16 PAE dhe 16 PAK), duke siguruar një mundësi tepër të mirë të një ofrimi sa më cilësor të mësimdhënies. Të njëjtën gjë nuk mund ta shprehim për laboratorët në funksion të këtij programi, pasi godina e fakultetit është në rikonstruksion

	dhe për këtë shkak nuk arritëm të shikonim bazën e plotë laboratorikë në dispozicion të tij.			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Sipas Rregullores së Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, si njësia kryesore e ofrimit të këtij programi studimi, objekt vlerësimi, ky Fakultet ofron programe të ciklit të parë të studimit, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. GVJ ju komunikua se procesi i kodifikimit të programit është në proces nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, proces që po kalon çdo program studimi që ofrohet në arsimin e lartë në vend.			
Konkluzione	GVJ shprehet se ofrimi i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi, është në përputhje me misionin dhe qëllimin e Universitetit Politeknik të Tiranës, me fushën akademike të njësisë kryesore të tij si Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, si dhe të njësisë bazë siç është Departamenti i Shkencave të Tokës, duke synuar ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Ashtu siç është shprehur edhe në raportin e vlerësimit të Brendshëm (RVB) por edhe sipas bisedave të zhvilluara nga Grupi i Vlerësuesve të Jashtëm (GVJ) të këtij programi, Universiteti Politeknik i Tiranës si një nga Institucionet e rëndësishme të arsimit të lartë publik në vend dhe Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, si njësia kryesore e ofrimit të programit të studimit, Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi, me një eksperiencë disa vjeçare, ofrojnë jo vetëm për këtë program studimi, objekt vlerësimi në kuadër të akreditimit për herë të parë të tij, por edhe për programet e tjera, marrëdhënie bashkëpunimi të frytshme dhe në funksion të programeve. Referuar dokumentit të paraqitur në DVV, (REF_045 – Raporti i analizës mësimore Staf Departament) jepet një informacion për ngarkesën mësimore të realizuar nga stafi akademik në vitin

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 922-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	akademik 2022-2023, të ndara sipas cikleve të studimit dhe parashikimin për vitin akademik 2023-2024. Sipas këtij materiali janë paraqitur të dhëna për çdo anëtar të Departamentit, lidhur me normën vjetore; ngarkesën totale të realizuar; orët e realizuara në ciklin e parë; orët e realizuara në ciklin e dytë; orët e realizuara në ciklin e tretë; si dhe ngarkesën sipas semestrave. Në fund të materialit, për këtë vit akademik është konstatuar se të gjithë pedagogët e DSHT kanë realizuar ngarkesën e tyre mësimore si dhe kanë realizuar mbingarkesë. Mbingarkesa e madhe e disa pedagogëve lidhet me daljen në pension ose largimin nga puna të disa pedagogëve efektivë të departamentit dhe mos zëvendësimin e tyre me të rinj. GVJ sugjeron që për një efikasitet më të mirë të punës së pedagogëve të Departamentit të Shkencave të Tokës por edhe të stafit të programit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, njësia kryesore duhet të marrë masa para fillimit të vitit të ri akademik, që të plotësojë vendet vakante të stafit akademik, në mënyrë që të shmangë mbingarkesën e stafit ekzistues. <i>Referenca:</i> <i>Ref_045 - Raporti i analizës mësimore Staf Departament</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	GVJ vëren se në Dosjen e vetëvlerësimit janë paraqitur dokumente në lidhje me marrëdhëniet dhe marrëveshjet e bashkëpunimit të UPT për realizimin e objektivave të programeve të studimit që ofron ky Institucion. Referuar dokumentit 046 – marrëveshjet Institucionale UPT, dhe dokumentit 048 – Marrëveshjet me industrinë dhe Institucione, janë paraqitur të dhëna për marrëveshjet institucionale të UPT, konkretisht: - Marrëveshje Institucionale me Universitetet vendase - Marrëveshje Institucionale me Universitetet e huaja - Marrëveshje Institucionale me kompani - Marrëveshje Institucionale me Institucione Shtetërore - Marrëveshje në kuadër të Erasmus + Për të gjitha marrëveshjet e listuara janë paraqitur fillimi i kohës së nënshkrimit të marrëveshjes dhe mbarimi i saj. Vërehet se Universiteti Politeknik i Tiranës, ndër vite, ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Në shumicën prej tyre afati i kohëzgjatjes së marrëveshjes është i pacaktuar. E njëjta gjë nuk vërehet tek marrëveshjet e UPT në kuadër të Erasmus +. Sipas tabelës së paraqitur, UPT ka lidhur marrëveshje me 34 institucione të huaja në kuadër të Erasmus +. Nga 34 Institucionet e listuara, vetëm me UNIËA, Greqi, marrëveshja është e vlefshme deri në 2027. Edhe me Politecnico di Torino, marrëveshja ka përfunduar në Maj 2024.

	Institucioni duhet të ofrojë më shumë përvoja bashkëpunuese të cilat shërbejnë si në mobilitetin e stafit ashtu edhe të studentëve në programet e studimit që ofrohen. <i>Referenca:</i> <i>Ref_046 - Marrëveshjet Institucionale</i> <i>Ref_048 - Marrëveshjet me Industrinë dhe Institucione</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Referuar RVB por edhe dokumentacionit të DVV, ashtu siç jemi shprehur edhe në Kriterin 2, konstatohet se ndër vite, me kompani dhe Institucione janë lidhur gjithsej 55 marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat me 42 prej tyre afati i bashkëpunimit është i pacaktuar. Ndërsa me Institucione shtetërore janë lidhur gjithsej 15 marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat me 10 prej tyre afati i bashkëpunimit është i pacaktuar. Nga një këqyrje e emrave të kompanive dhe Institucioneve me të cilat janë lidhur marrëveshjet e bashkëpunimit, vërehet se studentët e programit të BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi mund të kryejnë praktikat profesionale në këto kompani apo institucione, pasi natyra e funksionimit të kompanisë mund ti vijë në ndihmë studentëve të Gjeomjedisit për praktikimin e njohurive që kanë marrë gjatë studimeve në këtë program studimi. <i>Referenca:</i> <i>Ref_048 - Marrëveshjet me Industrinë dhe Institucione</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Sipas një dokumenti që është paraqitur në dosjen e vetëvlerësimit (Ref – 049 Model kontrate për praktikën FGJM) është paraqitur tip - kontratë për realizimin e praktikës mësimore të studentëve të Universitetit Politeknik të Tiranës. Sipas shkresës shoqëruese të Rektorit të UPT me Nr. 1269 Prot, datë 26.10.2016. Qëllimi i kësaj shkrese është unifikimi i modelit të kontratës që do të përdoret për zhvillimin e praktikës mësimore të studentëve të Universitetit Politeknik të Tiranës si dhe dosja që duhet të përgatisë çdo subjekt që do të pranojë studentët si praktikantë. Nuk ka ndonjë raport analitik për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. <i>Referenca:</i> <i>Ref – 049 - Model kontrate për praktikën FGJM</i>
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se Universiteti Politeknik i Tiranës ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, aktorë të biznesit, në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. GVJ konstaton se Institucioni duhet të ofrojë më shumë përvoja bashkëpunuese të cilat shërbejnë si në mobilitetin e stafit ashtu edhe të studentëve në programet e studimit që ofrohen. Gjithashtu</i>

	<i>duhet të përgatisë raporte analitike për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të praktikave mësimore të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Pranë gjimn. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga dokumentacioni i shqyrtuar nga GVJ si edhe nga RVB, programi i Studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi është ri formatuar dhe riorganizuar në përputhje me VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar. Duke iu referuar kurrikulës dhe rregullores së programit të studimit, GVJ vëren që Programi i Studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi është organizuar me lëndë bazë, pesha e të cilave është vlerësuar me kredite ECTS në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Brenda lëndës, tipologjitë didaktike të saj (leksione, ushtrime, laboratorë, praktika mësimore, etj.) vlerësohen me kreditet përkatëse dhe këto janë të pasqyruara qartë në planin mësimor të programit, po ashtu edhe në syllabuset e çdo lënde. Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë me 180 kredite për tre vite akademike, i ndarë në 6 semestra. <i>Referenca:</i> <i>Ref_010 Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_011 Plani mësimor i PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_023 Syllabuset e Lëndëve në PS BSC Inxhinieri Gjeomjedisi</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të	Duke iu referuar Planit Mësimor, Suplementit të Diplomës si edhe syllabuseve të programit të studimit, vlerësojmë se diploma bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi formon figurën profesionale të inxhinierit në fushën e gjeomjedisit me lëndë shumë disiplinore, të cilat japin koncepte profesionale zbatuese në drejtimin e njohjes, parandalimit dhe mënjanimin të fenomeneve që shkaktojnë prishjen dhe ndotjen e gjeomjedisit nga faktorë të ndryshëm. Nga takimi që patëm me me lektorët e lëndëve, studentët, por edhe nga studimi i kurrikulës dhe syllabuseve, ky program gjatë tre viteve i jep studentit njohuri bazë teorike, por edhe praktike në terren, si edhe njohuri më të thelluara të nevojshme për të qenë të aftë për punë ndërdisiplinore. Gjithashtu, gjatë takimit me studentët na u konfirmua që ata janë dërguar për praktika mësimore pranë bizneseve që zhvillojnë veprimtari në fushën e gjeomjedisit. Kjo gjë i bën ato të gatshëm për tregun e punës.

paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Përgatitja e studentit në këtë program bachelor, i jep mundësinë për të vazhduar ciklin e mëtejshëm të studimeve Master. <i>Referenca:</i> <i>Ref_010 - Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedi</i> <i>Ref_011 - Plani mësimor i PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedi</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e Lëndëve në PS BSC Inxhinieri Gjeomjedi</i> <i>Ref_051 - Modeli i Suplementit të Diplomës BSc në Inxhinieri Gjeomjedi</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe RVB, GVJ konstaton se Programi BSc në “Inxhinieri Gjeomjedi” është projektuar për të arritur objektivat formuese, përmbajtjen e strukturuar dhe rezultatet e parashikuara të të mësuarit që synojnë përvetësimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave që janë në përputhje me kërkesat e tregut duke promovuar punësimin e studentëve. Nga vlerësimi i dokumenteve dhe materialeve në DVV, ky program është përshtatur për të pajisur inxhinierë me aftësi praktike dhe teknike në fushën e gjeomjedisit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të tregut. Veprimtaritë formuese janë grupuar sipas kategorive: Lëndë bazë; Lëndë karakterizuese, Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese, Lëndë plotësuese, Detyrime përmbledhëse. Sipas kurrikulës dhe syllabuseve, veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë që karakterizojnë këtë program studimi ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë), forma të kontrollit të vazhdueshëm, studim individual (punim relacionesh, detyrash, projekte etj.), përgatitje për provime dhe përgatitja e temës së Diplomës. Pesha më e madhe u jepet lëndëve karakterizuese me 51%, e cila është në përputhje me kriterin Bachelor sipas VKM 41, date 24.01.2028. Gjithashtu, edhe kategoritë e tjera janë në përputhje me VKM. <i>Referenca:</i> <i>Ref_006 - Rregullore e brendshme FGJM</i> <i>Ref_010 - Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedi</i> <i>Ref_011 - Plani mësimor i PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedi</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Diploma bachelor në “Inxhinieri Gjeomjedi” ofrohet nga Fakulteti i Gjeologji Minierave që prej vitit 2012. Ky program përkon me nivelin 6 të Kornizës së Kualifikimeve Shqiptare dhe përbëhet nga 180 kredite. Ofrohet në gjuhën shqipe përmes studimit me kohë të plotë për një periudhë prej 3 vitesh akademike (6 semestra). Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur, GVJ vlerëson se programi ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke




	grumbulluar lëndët sipas kategorive të përcaktuara me ngarkesën përkatëse në kredite. - Lëndë bazë: 15-20% (kredite) ku përfshihen: Analizë matematike 1, Fizikë 1, Analizë matematike 2, Algjebër dhe Gjeometri, Kimi, Fizikë 2, Statistikë dhe Probabilitet. - Lëndë karakterizuese: 50-55% (kredite), ku përfshihen: Gjeologji e përgjithshme, Hyrje në Inxhinierinë e burimeve natyrore, Hyrje në burimet e energjisë dhe legjislacion, mekanika e zbatuar, Fizikë mjedisore, Shkenca e konstruksioneve 1, Ekonomiks Administrim biznesi, Mineralogji-Petrografi, Topografi, Shkenca e konstruksioneve 3, Hidraulika, Ekologjia e zbatuar, Mbrojtja dhe siguria në punë, Gjeokimi, Mekanika e fluideve nëntokësore, VNM, Hidrologji e zbatuar, Gjeofizikë, Gjeoteknikë, Aktiviteti minerar dhe mjedisi, - Lëndë ndërdisiplinore/integruese: 12-15% (kredite), Elektroteknikë dhe impiante, Lëndë me zgjedhje 1,2 dhe 3, - Lëndë plotësuese: 10-15% (kredite), Gjuhë e huaj, Vizatim Inxh. CAD, Etikë komunikimi, Informatikë - Lëndë Përmbyllëse: 3-5% (kredite), provim përfundimtar/punim Diplome. Në planin mësimor janë pasqyruar veprimtaritë formuese, siç janë praktikatat mësimore në terren për lëndët bazë formuese, punimi i diplomës, si edhe ngarkesa në kredite dhe shpërndarja e tyre për çdo lëndë. <i>Referenca:</i> <i>Ref_011 - Plani mësimor i PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisore</i>			
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Si pasojë e numrit të ulët të studentëve të regjistruar në vitet e fundit, sipas legjislacionit në fuqi Programi bachelor në “Inxhinieri Gjeomjedisore” është konsideruar si program me prioritet kombëtar. Studentët të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e duhura në përputhje me ligjin përfitojnë mbështetje financiare. Nga vizita në Sekretarinë Mësimore GVJ konstatoi se numri i studentëve të Programit të Studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisore ka pësuar ulje, përkatësisht: <table><tr><td>- Në vitin 2021 – 2022 janë regjistruar 28 studentë dhe çregjistruar 3 studentë;</td></tr><tr><td>- Në vitin 2022 – 2023 janë regjistruar 15 studentë dhe çregjistruar 1 student;</td></tr><tr><td>- Në vitin 2023 – 2024 janë regjistruar 9 studentë.</td></tr></table> Ndërkohë kuotat për këtë program studimi janë deri në 50 studentë.	- Në vitin 2021 – 2022 janë regjistruar 28 studentë dhe çregjistruar 3 studentë;	- Në vitin 2022 – 2023 janë regjistruar 15 studentë dhe çregjistruar 1 student;	- Në vitin 2023 – 2024 janë regjistruar 9 studentë.
- Në vitin 2021 – 2022 janë regjistruar 28 studentë dhe çregjistruar 3 studentë;				
- Në vitin 2022 – 2023 janë regjistruar 15 studentë dhe çregjistruar 1 student;				
- Në vitin 2023 – 2024 janë regjistruar 9 studentë.				

	<i>Referenca:</i> <i>Ref_026 - Praktika e miratimit të kuotave të pranimit të FGJM</i> <i>Ref_106 - Shpallja e programeve të studimit të FGJM "Prioritet Kombëtar"</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit si edhe vizitës në institucion, <i>GVJ konstatoi që program i studimit është i ngjashëm në masën 70% me programe të ngjashme studimi të ofruara nga institucione të tjera në vend.</i> Përkatësisht, vetë Universiteti Politeknik ofron programin bachelor në "Inxhinieri Mjedisi" në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, kurrikula e të cilit është pothuajse e ngjashme me këtë program. <i>Referenca:</i> <i>Ref_001 - Statuti i UPT</i> <i>Ref_062 - Mobilitetet e realizuara DSHT 2021 – 2024</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Nga vlerësimi i dokumentacionit si edhe RVB, programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi është i shoqëruar me kod përkatës sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra nga MAS. Forma e diplomës është e regjistruar në regjistrin shkencor me numër unik identifikimi: PO5446211208. Ky numër unik shënohet në diplomën që FGJM lëshon për këtë program studimi. GVJ vlerëson pozitivisht kodifikimin e lëndëve si aspekt thelbësor i administrimit akademik, duke ndihmuar në organizimin dhe identifikimin e lëndëve brenda kurrikulës. <i>Referenca:</i> <i>Ref_012 Forma e regjistruar e Diplomës BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i>
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, vërehet rëndësia që FGJM i jep programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi për të realizuar mobilitete të studentëve, për të kryer një pjesë të studimeve në një institucion jashtë Shqipërisë. Shembull është program Erasmus +, ku ofrohen programe të përbashkëta bachelor (por edhe master dhe doktoratë) ndërmjet universiteteve evropiane dhe partnerëve të tyre. Por, ajo që u vu re nga vizita në institucion dhe bashkëbisedimit me pedagogët dhe studentët e këtij programi, ishte numri i ulët i studentëve që bëhen pjesë e këtyre mobiliteteve, për shkak të nivelit të dobët të njohjes së gjuhës angleze. <i>Referenca:</i> <i>Ref_046 - Marrëveshjet Institucionale UPT</i>
Konkluzione	<i>Nga vlerësimi i dokumentacionit dhe vizitave në Institucion, GVJ konstaton që programi i studimit Bachelor në Inxhinieri</i>

	<i>Gjeomjedisi organizohet në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi si edhe akteve të brendshme rregullatorë, duke përmbushur plotësisht standardin II.1.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, njësia kryesore FGJM së bashku me njësitë e tjera bazë (përkatësisht 4 departamente), mban përgjegjësinë për përmbushjen e detyrimeve ligjore për strukturën akademike dhe organizimin e programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi. Kjo përfshin sigurimin e numrit dhe nivelit të kërkuar të kualifikimit të personelit akademik, si edhe krijimin e marrëdhënieve të qarta midis personelit me kohë të plote dhe me kohë të pjesshme. FGJM ka në përbërje katër departamente, përkatësisht: - Departamenti i Shkencave të Tokës, i cili përbëhet nga personel akademik prej 12 anëtarësh, prej të cilëve 7 me titullin Profesor, 2 Profesorë të Asociuar, 2 Doktorë Shkencash dhe 1 Doktoratë në proces. - Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare, përbëhet nga një personel akademik prej 11 anëtarësh, prej të cilëve 3 Profesorë, 2 Profesorë të Asociuar, 5 Doktorë Shkencash dhe 1 Master i Shkencave. - Departamenti i Burimeve të Energjisë, ka personel akademik prej 12 anëtarësh, prej të cilëve 2 Profesorë, 4 Doktorë Shkencash, 6 Master i Shkencave. - Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës, i cili ka personel akademik prej 14 anëtarësh, prej të cilëve 4 profesorë të Asociuar, 10 Doktorë Shkencash. Për sa më sipër Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit (Departamenti i Shkencave të Tokës) përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar, si dhe përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike Departamenti i Shkencave të Tokës:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<table><tr><th rowspan="2">Tituj/ grada</th><th colspan="2">2021 – 2022</th><th colspan="2">2022 – 2023</th><th colspan="2">2023 – 2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>8</td><td>2</td><td>8</td><td>2</td><td>7</td><td>3</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>2</td><td>1</td><td>2</td><td>1</td><td>2</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>3</td><td>2</td><td>3</td><td>2</td><td>2</td><td>3</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>1</td><td>3</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>2</td></tr><tr><td>Totali</td><td>14</td><td>8</td><td>14</td><td>5</td><td>12</td><td>9</td></tr></table>	Tituj/ grada	2021 – 2022		2022 – 2023		2023 – 2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	8	2	8	2	7	3	Prof. Asoc.	2	1	2	1	2	1	Dr./PhD.	3	2	3	2	2	3	Msc.	1	3	1	-	1	2	Totali	14	8	14	5	12	9
Tituj/ grada	2021 – 2022		2022 – 2023		2023 – 2024																																												
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																											
Prof.Dr.	8	2	8	2	7	3																																											
Prof. Asoc.	2	1	2	1	2	1																																											
Dr./PhD.	3	2	3	2	2	3																																											
Msc.	1	3	1	-	1	2																																											
Totali	14	8	14	5	12	9																																											
	<i>Referenca:</i> <i>Ref_001 - Statuti UPT</i> <i>Ref_006 - Rregullore e Brendshme FGJM</i> <i>Ref_008 - Rregullore e brendshme DSHT</i> <i>Ref_015 - Organigrama e FGJM</i>																																																
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Programi i studimit bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi është i pajisur me personel akademik dhe ndihmës të cilët posedojnë kualifikimet e nevojshme dhe përvojën profesionale për të kryer aktivitete mësimore dhe orët laboratorike në përputhje me standardet e vendosura profesionale. Nga vizita në Institucion dhe biseda me Përgjegjësen e Departamentit, Departamenti i Shkencave të Tokës (DSHT) ka vënë në dispozicion pedagog përgjegjës për mbështetjen e zhvillimit dhe të praktikës mësimore në terren. Praktika vlerësohet nëpërmjet relacionit të praktikës, të cilin studenti e dorëzon tek pedagogu/ët përgjegjës. - Për vitin 2023-2024 numri i PAE është 12 pedagogë; Numri i PAK 9 pedagogë; Numri i P. ndihmës akademik 4 pedagogë. - Për vitin 2022-2023 numri i PAE është 14 pedagogë; Numri i PAK 5 pedagogë; Numri i P ndihmës akademik 4 pedagogë. - Për vitin 2021-2022 numri i PAE është 14 pedagogë; Numri i PAK 8 pedagogë; Numri i P ndihmës akademik 4 pedagogë. Na u konfirmua gjithashtu se Institucioni ka lidhur gjithashtu edhe marrëveshje për realizimin e praktikave mësimore. <i>Referenca:</i> <i>Ref_054 - Model Marrëveshje për Praktikë Mësimore</i> <i>Ref_055 - Praktika shkresore për realizimin e Praktikave mësimore.</i>																																																

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Nga vlerësimi i dokumentacionit përkatës si edhe RVB, program i studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi organizohet dhe menaxhohet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS), i përbërë nga 5 anëtarë. Anëtarët janë propozuar nga Departamentet që bashkëpunojnë për këtë program studimi dhe janë miratuar nga Dekanati i FGJM. Drejtuesi i KPS është koordinator i programit të studimit. Nga dokumentacioni i vlerësuar, funksionet dhe detyrat e koordinatorit përcaktohen në “Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënës”. Koordinatori luan rolin e monitoruesit të punës për miradministrimin e programit si edhe përmbushjen e objektivave të tij. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënës</i> <i>Ref_006 - Rregullore e Brendshme FGJM</i> <i>Ref_010 - Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_020 - Vendim i DSHT për ngritjen e KPS</i>			
Konkluzione	Nga studimi dhe vlerësimi i dokumentacionit, RVB si edhe nga kontaktet gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Sipas dokumentacionit të vlerësuar nga GVJ, Departamenti i Shkencave të Tokës (DSHT) është përgjegjës për programin e studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi. Ai zotëron dhe disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi. Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim: - Rregulloren e programit të studimit; - Planin mësimor, në të cilin shprehet tërësia e veprimtarive formuese; - Programi mësimor i lëndës (syllabuse-t) për çdo lëndë; - Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënës e UPT-së. Konstatuam që të gjitha informacionet janë të aksesueshme nga të gjithë. Departamenti dhe çdo anëtar i personelit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	akademik/administrative ka akses të plotë tek dokumentet e sipërpërmendura. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënës</i> <i>Ref_010 - Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedi</i> <i>Ref_011 - Plani Mësimor i PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedi</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në BSc në Inxhinieri Gjeomjedi</i> <i>Ref_041 - Praktika e miratimit të Planeve Mësimore</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedi organizohet në tre vite akademike, me gjashtë semestra. Lëndët janë vlerësuar në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve ECTS, të pasqyruara në çdo syllabus. Në total kurrikula ka 180 kredite ECTS. Plani mësimor organizohet në lëndë dhe praktika mësimore të grupuara sipas kategorive: - Lëndë bazë, ose lëndë të kategorisë A; - Lëndë karakterizuese, ose lëndë të kategorisë B; - Lëndë ndërdisiplinore/integruese; - Lëndë plotësuese - Detyrime përmbyllëse. Në planin mësimor parashtrohen në mënyrë të përmblodhur: - Emërtimi i programit të studimit, viti akademik, njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse, fusha e studimit, kohëzgjatja normale e studimeve, forma e përmbylljes së studimeve, struktura mësimore e programit të studimit. - Tërësia e veprimtarive formuese, të grupuara në semestra dhe renditur sipas semestrave; - Kreditet për çdo veprimtari formuese, shpërndarjen e tyre brenda një disipline (leksione/ ushtrime/ seminare/ laboratorë/ detyra kursi/ projekte etj.), ngarkesa në auditor dhe jashtë auditorit, ngarkesa javore në auditor, mënyra e vlerësimit të lëndës. Vlerësojmë që ngarkesat sipas krediteve janë në përputhje me aktet nënligjore që kanë të bëjnë me arsimin e lartë kombëtar dhe Direktivat Evropiane. Nga vizita në IAL, si edhe nga bisedat me pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi, u konstatua që për shkak të rikonstruksionit të godinës së FGJM laboratorët nuk punonin me kapacitet të plotë. Pjesa më e madhe e pajisjeve ishin të ambalazuara dhe nuk patëm mundësi të shikonim si zhvillohen orët laboratorike dhe çfarë pajisjesh ka. <i>Referenca:</i> <i>Ref_010 - Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedi</i>

	<i>Ref_011 - Plani Mësimor i PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_041 - Praktika e miratimit të Planeve Mësimore</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Sipas dokumentacionit në RVB, zyra e pranimit të studentëve ju jep të interesuarve të gjithë informacionet e nevojshme lidhur me regjistrim, transferim apo ekuivalentim. Sipas takimeve dhe bisedave gjatë vizitës në IAL, para fillimit të çdo viti akademik UPT/FGJM/DSHT udhëzon publikun dhe palët e interesuara në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe specifike të programeve të studimit të ofruara përmes sesioneve informative në shkolla të mesme ose biznese si dhe takime të hapura të organizuara për studentët e ardhshëm. GVJ u qartësua se kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve publikohen në faqen elektronike të Universitetit, përpara fillimit të procesit të aplikimit dhe janë lehtësisht të aksesueshme. Në faqen zyrtare të UPT dhe në portalin U-ALBANIA janë pasqyruar rankimet e kandidatëve dhe studentët fitues, ku secili student ka fjalëkalimin dhe ka të drejtë të shikojë në kohë reale renditjen si edhe të dhëna e njoftime të tjera. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_010 Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_027 Praktika e miratimit të kriterëve të pranimit në FGJM</i> <i>Ref_042 Praktika e transferimit të studimeve FGJM</i> <i>Ref_043 Praktikë ekuivalentimi program i dytë studimesh në FGJM</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi vlerësojmë që ai jep informacione rreth lëndëve që zhvillohen dhe strukturës së tyre. Plani mësimor është hartuar dhe mund të rishikohet nga KPS-ja. Sipas dokumentacionit, ai miratohet paraprakisht nga Departamenti dhe kontrollohet dhe miratohet nga Dekanati. Programet e lëndëve (syllabuset) vlerësojmë që përmbajnë informacione të nevojshme në përputhje me VKM nr. 41. Syllabuset për lëndët në programin studimor BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi janë hartuar në përputhje me rregulloret duke përshkruar objektivat dhe aftësitë që studentët do të fitojnë, si dhe literaturën bazë të rekomanduar që përfshin përditësime shkencore nga pesë vitet e fundit. Temat që trajtohen çdo javë gjatë semestrit janë organizuar nga anëtarët e stafit akademik, të cilët vlerësojmë se kanë kualifikimet e nevojshme në fushat e tyre përkatëse (duke përfshirë titujt e tyre, gradat shkencore dhe studimet e përfunduara). Vlerësojmë që programet e lëndëve përmbajnë

	informacionet e nevojshme për praktikat, seminarët apo leksionet, si dhe të gjithë komponentët formues brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Vlerësojmë që syllabuset për secilën lëndë ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxëniet të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS. Në çdo syllabus janë përfshirë elementët e mëposhtëm: emrin dhe semestrin e lëndës, emrin e titullit/pedagogëve që do të mësojnë lëndën, emrin e Koordinatorit të Programit Studimor, njohuritë dhe aftësitë që do të japë kursi, temat teorike dhe praktike që do të adresohen, numri i orëve të shpenzuara në leksione, seminare, ushtrime, laboratorë dhe aktivitete të tjera, si dhe kreditet ECTS caktuar në kurs. Vlerësojmë gjithashtu se syllabuset detajojnë metodat dhe format e mësimdhënies, metodat e përdorura për vlerësimin e performancës së studentëve dhe detyrimet që studentët duhet të përmbushin, siç, janë frekuentimi dhe pjesëmarrja në projektet e kursit. Së fundi, në syllabuse jepet informacion mbi literaturën e detyruar dhe ndihmëse që studentët pritet të lexojnë dhe përdorin gjatë lëndës <i>Referenca:</i> <i>Ref_011 - Plani Mësimor i PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga vizita në IAL, na u pohua se përshtatshmëria dhe rregullimi i kurrikulës arsimore u ka mundësuar studentëve të jenë fleksibël gjatë gjithë programit dhe të përshtaten me mundësitë e punësimit. Gjithashtu, na u konfirmua se në fillim të çdo vit akademik, të gjitha modifikimet diskutohen dhe arkivohen në njësinë themelore. Procedura e rishikimit të programit të studimit janë jo më shumë se në masën 20%. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 Rregullore e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_041 Praktika e miratimit të planeve mësimore</i>			
Konkluzione	<i>Pas vizitës në Institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstaton që programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit duke përmbushur plotësisht standardin II.3</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi i këtij programi studimi është propozuar nga FGJM në vitin 2012 kur u hap për herë të parë. Emërtimi lidhet drejt për drejtë me përmbajtjen e kurrikulës dhe vlerësojmë se është bashkëkohor. Vlerësojmë se përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri shkencore dhe praktike për studentët, duke rritur mundësi për punësim. Ndërthurja e njohurive teorike (leksioneve) me ato praktike (ushtrime, laboratorë, praktika mësimore etj.) është bërë në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit si edhe vazhdimit të studimeve në ciklet e mëtejshme. <i>Referenca:</i> Ref_010 - Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi Ref_011 - Plani mësimor i PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi Ref_013 - Miratimi nga MAS i PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Nga shqyrtimi i planit mësimor vlerësojmë se lëndët dhe shpërndarja e tyre brenda vitit mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi. Kurrikula dhe lëndët janë të standardizuara. Gjithashtu, ngarkesa e krediteve, leksion-seminar/ laborator- praktikë- ushtrim- lëndë-projekt/ kursi i pavarur i punës së studentit janë të krahasueshme me programet analoge ndërkombëtare. Vlerësojmë se shpërndarja e lëndëve ka vijimësi logjike dhe praktike, ku njohuritë fitohen njëra pas tjetrës. Në fillim studenti merr njohuri me lëndët e formimit bazë (kategoria A), të cilat zënë 20,56% të ngarkesës së krediteve të programit të studimit dhe zhvillohen në vitin e parë të studimeve. Ndërsa për formimin specifik në Inxhinieri Gjeomjedisi janë lëndët karakterizuese (kategoria B), që zënë 51,67% të ngarkesës në kredite (ECTS) dhe zhvillohen kryesisht në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve. Pjesa më e madhe e lëndëve inxhinierike ka Detyra Kursi, sipas specifikave kryhen laboratorë në ndihmë të procesit të mësimdhënies. Por, nga vizita në IAL, laboratorët nuk zhvilloheshin në pjesën më të madhe të lëndëve, për shkak të rikonstruksionit të godinës së FGJM.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	Ndërsa lëndët me veprimtari të tjera (kategoria C, D dhe E) kanë peshë specifike më të vogël dhe janë plotësuese në formimin inxhinierik të studentit. Pjesa më e madhe e lëndëve janë të vlerësuara me 5 kredite. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_010 - Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedis</i> <i>Ref_011 - Plan mësimor i PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedis</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedis</i> <i>Ref_045 - Raporti i Analizës Mësimore Staf Departament</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë vlerësojmë se janë në përputhje me profilin e programit të studimit. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit akademik, dhe është e përafërt me programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik e praktik është në përputhje me VKM Nr.41 dt.24.01.2018. Ndarja e veprimtarive formuese ka një raport teori/praktikë të ekuilibruar, gjë që krijon mundësi për formim të plotë të studentit për arritjen e objektivave. <i>Referenca:</i> <i>Ref_011 - Plan mësimor i PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedis</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedis</i> <i>Ref_045 - Raporti i Analizës Mësimore Staf Departament</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ vlerëson se Programi i Studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedis ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Studenti merr njohuri me lëndët e formimit bazë (kategoria A), të cilat zënë 20,56% të ngarkesës së krediteve të programit të studimit dhe zhvillohen në vitin e parë të studimeve. Ndërsa për formimin specifik në Inxhinieri Gjeomjedis janë lëndët karakterizuese (kategoria B), që zënë 51,67% të ngarkesës në kredite (ECTS) dhe zhvillohen kryesisht në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik vlerësojmë që ndihmojnë në arritjen e objektivave formues dhe i bëjnë studentët më të aftë për t'u orientuar dhe vepruar në tregun e punës dhe për t'u përshtatur me ndryshimet në teknologjitë e reja në fushën e gjeomjedisit, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve

	Lëndët dhe përmbajtja e kurrikulës janë të organizuara sipas kategorive A-E me peshën specifike të përcaktuar në VKM konkretisht: - Lëndë bazë, ose lëndë të kategorisë A, 15-20 %; 20,56% - Lëndë karakterizuese, ose lëndë të kategorisë B, 50-55 %; 51,67% - Lëndë ndërdisiplinore/integruese, $\geq 70\%$; 72,23% - Lëndë plotësuese 10-15%, 11,66% - Detyrime përmbyllëse, 3-5%; 2,78% <i>Referenca:</i> <i>Ref_011 - Plani mësimor i PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_042 - Praktikë transferim studentësh</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Nga vizita në Institucion dhe bashkëbisedimi me stafin akademik dhe Përgjegjësen e Departamentit vlerësojmë se departamenti përpiqet dhe ka arritur të përditësojë lëndët dhe modulet në mënyrë të vazhdueshme, duke shtuar listën e literaturës së detyruar dhe ndihmëse në bibliotekën e institucionit, por edhe duke pasur si prioritet të vetin furnizimin e tyre me literaturë të 5 viteve të fundit. Literatura e përdorur në syllabuse është bashkëkohore. Programi i lëndëve dhe moduleve është përditësuar duke u bazuar në kërkesat e tregut Aktualisht, duke qenë se biblioteka e fakultetit të FGJ është mbyllur për shkak të rikonstruksionit të godinës, pedagogët dhe studentët përdorin bibliotekën elektronike, ose Bibliotekën Qendrore Shkencore të UPT-së. <i>Referenca:</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_062 - Mobilitetet e realizuara DSHT 2021-2024</i> <i>Ref_070 - Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i> <i>Ref_071 - Biblioteka digjitale</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Vlerësojmë se përmbajtja e programit BSc Inxhinieri Gjeomjedisi është bashkëkohore dhe plotëson kërkesat specifike të profesionit, si dhe kërkesat për kompetencat dhe praktikat që priten nga punëdhënësit në përputhje me nivelin 6 të KSHK-së. GVJ vlerëson se ky program jep njohuri dhe pajis inxhinierët me aftësitë e duhura teorike dhe profesionale. Duke iu referuar syllabuseve, Programi i Studimit në BSc Inxhinieri Gjeomjedisi ka përmbajtje didaktike, profesionale dhe shkencore shumë formuese dhe vlerësojmë që garanton përfitimin e dijeve dhe aftësive në fushën e gjeomjedisit për nivelin bachelor. <i>Referenca:</i>

	<i>Ref_010 - Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	GVJ vlerëson se përmbajtja e programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve në ciklet e tjera. Nga shqyrtimi i dokumentacionit si edhe bashkëbisedimi me Departamentin, DSHT ofron gjithashtu edhe dy programe të nivelit Master (MSc dhe MP) në fushën e Inxhinierisë së Gjeomjedisit. Gjithashtu, kurrikula dhe syllabuset e lëndëve vlerësojmë se janë bashkëkohore dhe i ofrojnë studentit perspektivë të lirë lidhur me pritshmërinë dhe kërkesat e tregut e punës si edhe mundësi punësimi. Referenca: <i>Ref_010 - Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i>			
Konkluzione	Nga vlerësimi i dokumentacionit, DVV, RVB si edhe takimeve gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton që struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, si edhe nga takimet që pati GVJ, programi i studimit bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi i nënshtrohet çdo vit një analize mësimore dhe shkencore mbi ecurinë dhe zbatimin e programit. Gjithashtu analiza zhvillohet edhe për ecurinë e studentëve, e cila raportohet në Raportin e Analizës Mësimore Staf - Departament. Gjithashtu, nga takimi me pedagogët dhe studentët e këtij programi, na u pohua se organizohen takime në terren të stafit akademik dhe ndihmës- akademik dhe studentëve me administrator dhe drejtues të sipërmarrjeve në fushat inxhinierike. Po kështu, studentët na pohuan se ishin të punësuar në disa prej këtyre sipërmarrjeve, duke sugjeruar dhe ndihmuar në përmirësimin e kurrikulës për tu përshtatur sa më mirë tregut të punës.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>Referenca: Ref_045 - Raporti i Analizës Mësimore Staf Departament</i>			
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Nga takimi që pati GVJ me studentët e këtij program studimi, na u konfirmua se Institucioni mbante kontakte të vazhduara me to përmes koordinatorit dhe pedagogëve të lëndëve. Për përmirësimin e kurrikulës studentët plotësonin në mënyrë anonime çdo vit anketën, e cila i vjen online në emailin e tyre. Sipas rezultateve të anketave, Departamenti merrte masa për përmirësimin e programit të studimit. Ajo që vlen të përmendet është numri i vogël i studentëve që përfshiheshin në këtë anketim. Pjesëmarrja e studenteve në anketim është 70-80% në rang Universiteti, ndërsa në rang Fakulteti 5%. piket i stafit akademik për institucionin nuk bëhet. <i>Referenca:</i> <i>Ref_001 - Statuti i UPT</i> <i>Ref_061 - Anketimi Studentor – Pyetësori dhe raporti</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Njësia përgjegjëse për përmirësimin e programit të studimit është Departamenti i Shkencave të Tokës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit por edhe nga takimi dhe biseda me përgjegjësen e departamentit si edhe me pedagogët e këtij program studimi, na u theksua se programi i studimit ishte në përmirësim të vazhdueshëm në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë dhe institucione publike e private. <i>Referenca: Ref_011 - Tabela 11</i>			
Konkluzione	<i>Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ vlerëson se Fakulteti i Gjeologji Minerave, në veçanti Departamenti i Shkencave të Tokës nxit përfshirjen e studentëve partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga studimi i kurrikulës së programit të studimit bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi, format e mësimdhënies, mësim nxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat (ushtrime, detyra kursi, projekte). Këto janë të detajuara në Planin Mësimor dhe në syllabuset e këtij program studimi. Vlerësojmë se hartimi dhe miratimi i tyre është mbështetur në VKM nr.41 dt. 24.01.2018 si edhe nga Rregulloret e Universitetit dhe rregulloren e programit të studimit. Senati ka miratuar në fund të çdo viti akademik planet mësimore të këtij program studimi, kur ka qenë nevoja e riorganizimit të tij deri në masën 20%. <i>Referenca:</i> Ref_011 - Plani mësimor i PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeomjedisi Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref_010 - Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi Ref_041 - Praktika e Miratimit të Planeve Mësimore
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësim nxënies.	Nga dokumentacioni i paraqitur, por edhe nga takimi që pati GJV me personelin akademik të përfshirë në këtë program studimi, vërehet profesionalizmi i pedagogëve si edhe përkushtimi i tyre për të ofruar forma, mënyra si edhe metoda alternative të mësimdhënies dhe mësim-nxënies për studentët e kësaj dege. GJV iu shpjegua që një nga këto forma ishte zhvillimi i mësimin në platformën Google Classroom, si një mënyrë elektronike e të mësuarit për dhënien e njohurive, mësimdhënies duke shfrytëzuar teknologjinë. Megjithatë, nga vizita që patëm në IAL, klasat nuk kishin projektor, kompjuterë apo mjete të tjera audio-visive për të bërë prezantime, për të shfaqur video, apo për të pasur mundësi aksesit në bibliotekën digjitale të UPT-së etj. Edhe pse përkushtimi dhe profesionalizmi i pedagogëve është i madh, vlerësojmë se mungesa e teknologjisë në ambientin ku zhvillohet mësimi ndikon në cilësinë e mësimdhënies dhe mësim-nxënies. <i>Rekomandim:</i> Për të rritur cilësinë e mësimdhënies, rekomandojmë institucionin që të pajisë profesorët me projektor apo me mjete të tjera

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Prancë gim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<i>teknologjike për të zhvilluar mësim sa më bashkëkohor, deri në përfundim të rikonstruksionit të godinës së FGJM.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_039 - Udhëzues dhe manual për zhvillimin e mësimi në distancë</i> <i>Ref_064 - Shembull klase virtuale në platformën Google Classroom</i> <i>Ref_071 - Biblioteka digjitale</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Nga dokumentacioni i programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, GVJ vlerëson se institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe Workshop-e me profesorë të ftuar nga universitete të ndryshme. Nga takimi në IAL, na u konfirmua se FGJM ka mbështetur financiarisht trajnimin e pedagogëve në universitete homologe evropiane. <i>Referenca:</i> <i>Ref_046 -Marrëveshjet Institucionale UPT</i> <i>Ref_062 - Mobilitetet e realizuara DSHT 2021 - 2024</i> <i>Ref_063 - Praktikë për miratimin shpenzimesh për trajnimin e stafit akademik DSHT</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga dokumentacioni i programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, GVJ vlerëson se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është i kualifikuar sipas profilit të lëndës që zhvillon dhe i përkasin kategorisë profesor, doktor dhe MSc. Ngarkesa mësimore është e planifikuar nga Njësia Bazë, duke u mbështetur në normat e ngarkesës mësimore të përcaktuara nga udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë. Vlerësojmë se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në programin BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, duke përdorur metoda të ndryshme të mësimdhënies. Në të njëjtën kohë stafi akademik siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. Megjithatë, nga vizita që patëm në IAL, klasat nuk kishin projektor, kompjuterë apo mjete të tjera audio vizive për ta bërë mësimin më nxitës me prezantime, apo video. Mendojmë se kjo gjë ndikon në cilësinë e mësimdhënies dhe mësim-nxënies, edhe pse niveli dhe kualifikimi i pedagogëve është i lartë (referuar CV-ve të tyre). <i>Referenca:</i> <i>Ref_024 - CV e stafit akademik</i>

	<i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_052 - Procedura e punësimit të personelit PAE në UPT</i> <i>Ref_053 - Procedura e punësimit të personelit PAK në UPT</i> <i>Ref_065 - Praktikë punësimi staf akademik DShT</i> <i>Ref_061 - Anketimi Studentor – Pyetësi dhe raporti</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeomjedisi</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Nga vlerësimi i dokumentacionit por edhe nga takimi që patëm me Dekanin dhe Përgjegjësen e Departamentit, na u konfirmua se institucioni ka mbështetur personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. FGJM ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe jashtë vendit për shkëmbimin e personelit akademik, nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta, organizimin e konferencave, trajnimeve etj. Gjithashtu, nëpërmjet mënyrave të tjera si për shembull: “plotësimi i pyetësorëve të vlerësimit”, institucioni lexon dhe interpreton mendimet dhe sugjerimet e studentëve në lidhje me problematikat e procesit mësimor. Pas kësaj instancat administrative të UPT kryejnë verifikimet përkatëse, pasi vlerësimi është anonim dhe propozon masat përkatëse. Na u konfirmua se deri tani nuk ka pasur vlerësime negative. Kjo gjë na u vërtetua nga zyra e NJSBC gjatë takimit në IAL. Bazuar në Referencat, vlerësimi i cilësisë në mësimdhënie sigurohet nëpërmjet: - Pyetësorit të studentit i cili vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie; - Raporti i analizës mësimore Staf-Departament - Raporti i aktivitetit Kërkimor- Shkencor pedagog- Departament <i>Referenca:</i> <i>Ref_045 - Raporti i Analizës Mësimore Staf Departament</i> <i>Ref_046 - Marrëveshje Institucionale UPT</i> <i>Ref_061 - Anketimi Studentor – Pyetësi dhe raporti</i> <i>Ref_063 - Praktikë për miratim shpenzimesh për trajnim stafi akademik DSHT</i> <i>Ref_072 - Raporti i aktivitetit të Kërkimit Shkencor pedagog – departament</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në	Nga dokumentacioni i programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, GVJ vlerëson se institucioni mbështet financiarisht trajnimin e stafit akademik në universitete homologe jashtë vendit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Vlerësojmë se DSHT ka mbështetur eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnimin e vazhdueshëm të personelit akademik për

kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. Megjithatë, nga vizita që patëm në institucion nuk arritëm të shohim laboratorët dhe pajisjet moderne për shkak të rikonstruksionit të godinës. <i>Referenca:</i> <i>Ref_046 - Marrëveshje Institucionale UPT</i> <i>Ref_050 - Informacion Laboratorët FGJM</i> <i>Ref_062 - Mobilitetet e realizuara DSHT 2021 – 2024</i> <i>Ref_063 - Praktikë për miratim shpenzimesh për trajnim staf akademik DSHT</i> <i>Ref_105 Modernizimi i laboratorëve</i>			
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, por edhe nga vizita në IAL, GVJ vlerëson se Institucioni i arsimit të lartë garanton kryesisht procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Sipas dokumentacionit, rregullorja e programit të studimit përcakton kriteret dhe mënyrën e testimit të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Nga takimi me stafin akademik, gjithçka i bëhet e qartë studentit gjatë javës së orientimit nga pedagogët e lëndëve. Rregullorja e programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, Rregullorja e DSHT, si edhe Rregullorja e FGJM janë publike dhe studentët mund ta aksesojnë nga faqja e web-it. Për të përcaktuar mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve, institucioni ka hartuar dhe miratuar "Procedurën e kontrollit dhe Vlerësimit të Dijeve në FGJM". <i>Referenca:</i> <i>Ref_006 - Rregullore e brendshme e FGJM</i> <i>Ref_008 - Rregullore e brendshme e DSHT</i> <i>Ref_010 - Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_038 - Procedura e Vlerësimit të Dijeve në FGJM</i>

Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimi dhe biseda me pedagogët e programit të studimit Bsc në Inxhinieri Gjeomjedisi na u konfirmua se në javën e parë të semestrit akademik studentët njihen me programin e lëndës, përmbajtjen e saj, si edhe formën e vlerësimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Në çdo syllabus përcaktohet edhe vlerësimi i studentëve. Kriteret e vlerësimit përcaktohen nga titullari i lëndës dhe pasqyrohen në programin e lëndës përkatëse. <i>Referenca:</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_038 - Procedura e Vlerësimit të Dijeve në FGJM</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Duke iu referuar RVB, syllabuseve të lëndëve si dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion rezulton, se për të gjitha lëndët vlerësimi është me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Gjithashtu përfshihen forma të ndryshme vlerësimi, si projekte, detyra kursi, provime të ndërmjetme, punët laboratorike etj. Rregullat apo specifikat e provimeve, si edhe pesha e tyre janë të specifikuara qartë në syllabusin e çdo lëndë të programit. GVJ është e mendimit se këto forma të ndryshme vlerësimi, nxisin angazhimin e studentit dhe janë në përputhje me diversitetin e studentëve dhe të nivelit të tyre të angazhimit. <i>Referenca:</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_038 - Procedura e Vlerësimit të Dijeve në FGJM</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies vërehet që UPT ka strukturën e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtorinë e Kurrikulave. Nga vizita në institucion dhe bisedat e kryera me këto drejtori na u pohua se këto struktura janë përgjegjëse për respektimin e standardeve të përgatitjes së planeve mësimore, syllabuseve të lëndëve si edhe të gjithë dokumentacionin e programit të studimit me qëllim rritjen e cilësisë së stafit akademik. Për vlerësimin dhe cilësinë e personelit akademik përfshihen edhe student. Studenti plotëson pyetësorët online të përgatitura nga DSBC në mënyrë anonime në fund të çdo semestri. Mendimet dhe sugjerimet e studentëve reflektohen në dekanat dhe më pas në departament. Nga vizita dhe bashkëbisedimi me studentët por edhe me drejtoritë përkatëse GVJ vlerëson se numri i studentëve të cilët marrin pjesë në anketim është shumë i vogël (5% në rang fakulteti). <i>Rekomandim:</i> <i>Mendojmë që për të rritur cilësinë për të përmirësuar metodat e mësimdhënies duhen motivuar studentët për tu bërë pjesë në këtë</i>

	proces dhe duhen reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre sa më saktë. Referenca: Ref_005 - Organigrama e UPT Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref_045 - Raporti i Analizës Mësimore Staf Departament			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga vlerësimi i dokumentacionit, si edhe nga vizita në institucion, GVJ vlerëson se institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Një nga këto forma ishin detyrat e kursit, projektet e kursit, praktikat e zhvilluara në terren si edhe prezantimet e ndryshme. Një formë tjetër na u paraqit edhe komunikimi elektronik i pedagogëve përmes Google Classroom. Referenca: Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeomjedisi Ref_064 - Shembull klase virtuale në platformën Google Classroom			
Konkluzione	GVJ vlerëson se Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre duke përbushur plotësisht standardin III.2			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rregulloreve, syllabuseve etj., GVJ vlerëson se testimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet përgjatë gjithë vitit akademik nëpërmjet: provimeve me gojë, me shkrim, ose të kombinuara, detyrave të kursit, projekteve të kursit, kontrollit të laboratorëve etj.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Gjithashtu, FGJM ka zbatuar një procedurë të veçantë, me qëllim përcaktimin e rregullave dhe mënyrës së realizimit të kontrollit të dijeve, për të arritur vlerësimin objektiv dhe të paanshëm të studentit. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_038 - Procedura për Vlerësimin e Dijeve në FGJM</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, por edhe nga komunikimi gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton që UPT nuk ka në zbatim një sistem elektronik testimi dhe vlerësimi të studentëve, e cila do ndihmonte në transparencën dhe uljen e abuzimit dhe subjektivitetin në vlerësimin e studentëve. <i>Evidencë: Video tutorial për përdorimin e platformës BIT ALBANIA (Ref_040)</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, syllabuseve dhe planit mësimor të programit të studimit Bsc në Inxhinieri Gjeomjedisi, vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. <i>Referenca:</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeomjedisi</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga biseda me pedagogët e programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, na u konfirmua se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale është shoqëruar me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) në fletoret e korrigjimit në rastin e provimeve me shkrim, ose komente direkt në rastin e provimeve me gojë apo detyrave/projekteve të kursit. Në këto forma vlerësimi, na u saktësua që studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni korrigjues jo me vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e dhënies së provimit. Gjithashtu, nga biseda që bëmë me studentët, na u tha se ata kishin të drejtë të sqaroheshin për çdo paqartësi apo pretendim të tyre. Për të rritur transparencën, studentët kishin të drejtë të ankoreshin, në rast shkelje rregullash procedurale. Ankesa depozitohej me shkrim në sekretaren e dekanit, brenda 3 ditëve nga shpallja e rezultatit. <i>Referenca:</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_038 - Procedura për Vlerësimin e Dijeve në FGJM</i> <i>Ref_104 - Model ankimi provimi nga studentët e DSHT</i>

Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Nga dokumentacioni i paraqitur, në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënës në UPT, janë përcaktuar veprimet e ndaluara gjatë zhvillimit të provimit, përfshirë dhe kopjimi në provime dhe detyra. Na u siguria që pedagogu i lëndës, ose komisioni i provimit, janë të përgjegjshëm dhe zbatojnë me përpikëri rregulloren dhe Kodin e Etikës, për të shmangur dhe zvogëluar mundësinë e plagjiaturës, kopjimin dhe njëkohësisht propozojnë procedura të mëtejshme pranë autoriteteve dhe njësite përgjegjëse të UPT për ndjekjen dhe zbatimin e Kodit të Etikës. <i>Referenca:</i> Ref_003 - Kodi i Etikës i UPT Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref_038 - Procedura për Vlerësimin e Dijeve në FGJM
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga takimi me pedagogët e DSHT gjatë vizitës në Institucion, por edhe nga dokumentacioni që na është vënë në dispozicion, procesi i vlerësimit të dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët bëhej në përputhje me përcaktimet sipas Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Në këto forma vlerësimi, na u saktësua që studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni korrigjues jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e dhënies së provimit. Gjithashtu, nga biseda që bëmë me studentët, na u tha se ata kishin të drejtë të sqaroheshin për çdo paqartësi apo pretendim të tyre. Për të rritur transparencën, studentët kishin të drejtë të ankoreshin, në rast shkelje rregullash procedurale. Ankesa depozitohet me shkrim në sekretarinë e dekanit, brenda 3 ditëve nga shpallja e rezultatit. <i>Referenca:</i> Ref_004 Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref_023 Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeomjedisi Ref_038 Procedura për Vlerësimin e Dijeve në FGJM
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Nga vizita në Institucion dhe biseda me pedagogët dhe studentët e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, na u sqarua se komisioni i provimeve u bën me dije studentëve rezultatin e vlerësimit, duke sqaruar studentët për çdo paqartësi. Ata kanë të drejtë të kundërshtojnë këtë rezultat, duke u ankuar me shkrim në sekretarinë e dekanit Brenda 3 dite pune nga shpallja e rezultatit. Çdo kërkesë, ankesë, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Vlerësojmë se procedura e ndjekur është transparente për palët e përfshira dhe është e dokumentuar.

Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Referenca: Ref_001 - Statuti i UPT Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref_038 - Procedura për Vlerësimin e Dijëve në FGJM			
Konkluzione	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në Institucion, GVJ vlerëson që FGJM siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo student duke përfshirë edhe procesin e ankimimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Vlerësojmë se përmbajtja e programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të studimeve. Krahas njohurive teorike, vlerësojmë se programi synon mbi të gjitha aftësimin praktik dhe inxhinierik të studentëve. Gjatë viteve të ekzistencës së programit të studimit janë diplomuar dhjetëra studentë që janë punësuar edhe në tregun e brendshëm edhe të jashtëm të punës. GVJ shqyrtoi kurrikulën e këtij program dhe konstaton që ajo është e ngjashme me programe të tjera të këtij karakteri brenda e jashtë vendit. Bazuar në të gjitha këto GVJ vlerëson plotësimin e këtij kriteri. Gjatë vitit 2022 janë diplomuar 20 studentë. Gjatë viti 2023 janë diplomuar 25 studentë. Referenca: Ref_010 - Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi Ref_011 - Planit mësimor PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Nga studimi i Planit mësimor dhe Kurrikulës së PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, vlerësojmë se programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit nëpërmjet lëndëve si: Bazat e Informatikës, Teknologji Informacioni, teknikat e komunikimit, Gjuhë e huaj, CAD, GIS etj.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>Evidencë: Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi (Ref_010)</i> <i>Evidencë: Plani mësimor PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi (Ref_011)</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga bashkëbisedimi me studentët, ata na konfirmuan se njihen me kurrikulën syllabusin e lëndës. Pra, për çdo lëndë ata kanë mundësi të ndjekin ecurinë e programit sipas syllabusit. Në takimin me DSHT, GVJ mësoi se pedagogët tërheqin mendimin e studentëve për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të përmbytjes së lëndëve. Si një test për të kuptuar se sa kanë përfituar studentët shërben edhe detyra e kursit apo detyra praktike, që realizohet në fund të lëndës. Në këtë kuadër personeli akademik ka vazhdimisht sugjerime, propozime dhe komente të studentëve për PS dhe syllabuset të cilat ai i merr në konsideratë për të reflektuar. Vlerësojmë se kjo praktikë e ndihmon studentin që të verë në pah çështjet më të rëndësishme dhe t'i orientojë ato për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. <i>Referenca:</i> <i>Ref_045 - Raporti i Analizës Mësimore Staf Departament</i> <i>Ref_047 - Rendi i ditës së mbledhjes APA</i> <i>Ref_061 - Anketimi Studentor- Pyetësi dhe Raporti</i> <i>Ref_082 - Raport mbi anketimin studentor, cilësia e mësimdhënies, Sem I 2021-2022</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Nga takimi me stafin akademik të PS në BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi na u konfirmua se format e mësimit dhe kontrollit të dijeve harmonizohen përmes raporteve të caktuara, të cilat siç i shqyrtoam në dokumentacion, janë të parashikuara në Planin Mësimor. Sipas dokumentacionit, format kryesore të punës mësimore ishin: - Format e mësimit teorik dhe praktik (leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, detyrat e kursit, projektet e kursit etj.) - Format e kontrollit të dijeve (mbrojtja e punëve laboratorike, detyrave/projekteve të kursit, provimet etj.) Nga diskutimi me studentët na u konfirmua se personeli akademik i ka mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ka krijuar klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore duke ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. <i>Referenca:</i> <i>Ref_045 - Raporti i Analizës Mësimore Staf Departament</i> <i>Ref_050 - Informacion Laboratorët FGJM</i>

	<i>Ref_068 - Evidenca mbi laboratorët në UPT</i> <i>Ref_105 - Modernizimi i laboratorëve të DSHT</i> <i>Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_078 - Përfshirja e studentëve në veprimtari kërkimi FGJM</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga vizita në Institucion dhe diskutimi me personelin akademik të PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, na u konfirmua se pedagogët efektiv dhe me kontratë kanë realizuar orë të hapura dhe seminare mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë në fushën e gjeomjedisit. Gjithashtu, kanë organizuar seminare dhe workshop-e me përfshirjen edhe të studentëve. <i>Referenca:</i> <i>Ref_78 - Përfshirja e studentëve në veprimtari kërkimi</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që program i studimit "BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi" garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato, duke përmbushur plotësisht këtë standard.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar mbi "Procedurën e Konceptimit dhe Mbrojtjes së Diplomës", GVJ vlerëson se Institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit është përcaktuar pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e më pas është bërë publike. Vlerësojmë se kjo procedurë është zbatuar korrekt nga Departamenti. <i>Referenca:</i> <i>Ref_056 - Procedura Konceptimi dhe Mbrojtja e Diplomës Bachelor</i> <i>Ref_057 - Urdhri i Dekanit FGJM për mbrojtjen e Diplomave</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në	Nga shqyrtimi i "Procedurës së Konceptimit dhe Mbrojtjes së Diplomës" GVJ vlerëson se strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. Dekani është përgjegjës për të kontrolluar nëse kjo procedurë zbatohet, ndërsa drejtuesi i departamentit është përgjegjës për krijimin e fondit të temave të diplomave, shpalljen e temave

funksion të detyrimeve përmbyllëse.	potenciale të punimit të tyre, ngritjen e komisionit të mbrojtjes së diplomës, përcaktimin e numrit të studentëve që do mbrojnë diplomën si edhe kontrollin përfundimtar. Vlerësojmë se këto struktura kanë përmbushur plotësisht këtë kriter. <i>Referenca:</i> <i>Ref_056 - Procedura Konceptimi dhe Mbrojtja e Diplomës Bachelor</i> <i>Ref_057 - Urdhri i Dekanit FGJM për mbrojtjen e Diplomave</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Sipas “Procedurës së Konceptimit dhe Mbrojtjes së Diplomës” punimi final bëhet përmes mbrojtjes së diplomës ose provimit të formimit. Teza e diplomës mbrohet para komisionit të posaçëm për administrimin e provimit final. Komisioni i diplomës përbëhet nga 3 (tre) – 5 (pesë) anëtarë. Ndërsa provimi i formimit kryhet pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve që përmban plani mësimor. Punimi final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. <i>Referenca:</i> <i>Ref_010 - Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_085 - Model fletoreje provimi</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Nga dokumentacioni i paraqitur, por edhe nga diskutimi gjatë vizitës në Institucion na u sqarua se udhëheqja e temës së diplomës në DSHT-FGJM kryhet nga stafi akademik i brendshëm ose i ftuar. Studenti zgjedh Udhëheqësin (i brendshëm ose i ftuar) dhe më pas miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Kriteret që duhet të përmbushë udhëheqësi janë përcaktuar me vendim Departamenti/Dekanati. <i>Referenca:</i> <i>Ref_010 - Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_056 - Procedura Konceptimi dhe Mbrojtja e Diplomës Bachelor</i> <i>Ref_057 - Urdhri i Dekanit FGJM për mbrojtjen e Diplomave</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Nga biseda me studentët e BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi na u konfirmua se Njësia bazë ka asistuar studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. FGJM ka vënë në dispozicion të gjitha mjediset laboratorike dhe pajisjet që ata disponojnë, në shërbim të kryerjes së analizave apo matjeve të ndryshme. <i>Referenca:</i> <i>Ref_006 - Rregullore e Brendshme FGJM</i>



	<i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_050 - Informacion për laboratorët DSHT</i> <i>Ref_068 - Evidenca mbi laboratorët në UPT</i> <i>Ref_105 - Modernizimi i laboratorëve në DSHT</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Nga dokumentacioni mbi rregulloret e punimit final të diplomave ose provimit përfundimtar si edhe bashkëbisedimit me studentët e PS në BSc Inxhinieri Gjeomjedisi, studentët janë vlerësuar në çdo rast me notë. <i>Referenca:</i> <i>Ref_080 - Shembull Procesverballi Mbrojtje Diplomash FGJM</i> <i>Ref_056 - Procedura Konceptimi dhe Mbrojtja e Diplomës Bachelor</i> <i>Ref_057 - Urdhër i Dekanit FGJM për mbrojtjen e Diplomave</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Nga dokumentacioni i vlerësuar, por edhe nga takimet me stafin akademik dhe Përgjegjësen e Departamenti, na u pohua se në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit u është vënë në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. Çdo formë diplome dhe certifikate, përpara se të lëshohet nga UPT, është regjistruar në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Diploma lëshohet deri në 6 muaj pas përfundimit të studimeve. Deri në pajisjen me Diplome, universiteti lëshon një vërtetim për diplomën e fituar. <i>Referenca:</i> <i>Ref_010 - Rregullore e PS në BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_004 - Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref_012 - Forma e Regjistruar e Diplomës BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_051 - Modeli i Suplementit të Diplomës BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_074 - Model Programi Mësimor në BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi shqip dhe anglisht.</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Nga takimi me Sekretarinë Mësimore, pamë që kjo strukturë administron, menaxhon dhe ruan dokumentacionin e studentëve për çdo program studimi. SM ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe ka për detyrë të paraqesë rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. GVJ vuri re se Regjistri themeltar ishte i plotësuar me shkrim dhe pa korrigjime.

	<i>Referenca:</i> <i>Ref_006 - Rregullore e brendshme FGJM</i> <i>Ref_081 - Rregullore e Sekretarisë Mësimore FGJM</i> <i>Ref_030 - Model i regjistrave në SM</i>			
Konkluzione	<i>Nga vizita në Institucion dhe vlerësimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson pozitivisht Institucionin, i cili ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																																							
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Njësia kryesore e FGJM, së bashku me njësinë bazë të DSHT, mban përgjegjësinë për përmbushjen e detyrimeve ligjore për strukturën akademike dhe organizimin e programit studimor “BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi”. Kjo përfshin sigurimin e numrit dhe nivelit të kërkuar të kualifikimit të personelit akademik, si dhe krijimin e marrëdhënieve të qarta midis personelit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Nga vizita në institucion dhe takimi me Sektorin e Burimeve Njerëzore, na u demonstruan dosjet e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, në të cilin ishin të përfshira të gjitha dokumentet e kualifikimit të pedagogëve. Gjithashtu, nga studimi i dokumentacionit të depozituar dhe bisedës me Sektorin e BNJ, GVJ vlerëson se: - SBNJ nuk ka përfaqësues në grupin e marrjes në punë për pedagogët e jashtëm, për të ndjekur ligjshmërinë juridike dhe procedurën administrative. - Pedagogët e brendshëm nuk plotësojnë dosjen e vetëvlerësimit. - Nuk përcaktohen pikët për kriteret e punësimit. Pikësimi bëhet subjektiv nga anëtarët e komisionit, pasi nuk është përcaktuar se sa pikë ka secili kriter. - Kur hapet thirrja për punësim, nuk përcaktohen se cilat janë pikët për intervistën me gojë dhe me shkrim. Të dhënat e stafit akademik për program studimi. Në lidhje me titujt dhe gradat e stafit, duke ju referuar të dhënave të Tabelës 6.1, kemi: <table><tr><th rowspan="2">Stafi akademik i programit të studimit</th><th colspan="2">2021 – 2022</th><th colspan="2">2022 – 2023</th><th colspan="2">2023 – 2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr</td><td>15</td><td>-</td><td>11</td><td>-</td><td>9</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof.As.Dr</td><td>13</td><td>-</td><td>12</td><td>-</td><td>9</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>22</td><td>1</td><td>20</td><td>1</td><td>19</td><td>1</td></tr><tr><td>Dr në proces</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td><td>6</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc</td><td>8</td><td>3</td><td>8</td><td>-</td><td>4</td><td>-</td></tr><tr><td>Total</td><td>59</td><td>4</td><td>52</td><td>1</td><td>47</td><td>1</td></tr></table> <i>Rekomandim:</i>	Stafi akademik i programit të studimit	2021 – 2022		2022 – 2023		2023 – 2024		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr	15	-	11	-	9	-	Prof.As.Dr	13	-	12	-	9	-	Dr/PhD	22	1	20	1	19	1	Dr në proces	1	-	1	-	6	-	Msc	8	3	8	-	4	-	Total	59	4	52	1	47	1
Stafi akademik i programit të studimit	2021 – 2022		2022 – 2023		2023 – 2024																																																			
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																		
Prof.Dr	15	-	11	-	9	-																																																		
Prof.As.Dr	13	-	12	-	9	-																																																		
Dr/PhD	22	1	20	1	19	1																																																		
Dr në proces	1	-	1	-	6	-																																																		
Msc	8	3	8	-	4	-																																																		
Total	59	4	52	1	47	1																																																		

	<i>Vlerësojmë që forma e punësimit për pedagogët full time dhe part time në UPT të jetë më transparente. Çdo kriter duhet të jetë i përcaktuar qartë me pikët përkatëse. Gjithashtu, duhet të përcaktohen pikët për intervistën me gojë (ose % që zë intervista me gojë, kundrejt dosjes me dokumente)</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref_001 - Statuti i UPT</i> <i>Ref_005 - Organigrama e UPT</i> <i>Ref_006 - Rregullore e brendshme FGJM</i> <i>Ref_008 - Rregullore e brendshme DSHT</i> <i>Ref_024 - CV stafit akademik</i>												
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar nga GVJ rezulton se personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme mbulon ngarkesën mësimore sipas kornizës ligjore në fuqi. Duke studiuar të dhënat e PAE dhe PAK në rang program studimi rezulton përkatësisht se: <table border="1"> <tr> <td>- Për vitin 2023</td><td>- 2024 numri i PAE është 47 pedagogë; Numri i PAK 1 pedagogë, sipas tabelës 6.1</td></tr> <tr> <td>- Për vitin 2022</td><td>- 2023 numri i PAE është 53 pedagogë; Numri i PAK 1 pedagogë; sipas tabelës 6.2</td></tr> <tr> <td>- Për vitin 2021</td><td>- 2022 numri i PAE është 60 pedagogë; Numri i PAK 5 pedagogë, sipas tabelës 6.3.</td></tr> </table> Ndërsa numri i PAE dhe PAK në rang Departamenti sipas Tabelës 2.1 është: <table border="1"> <tr> <td>- Për vitin 2023</td><td>- 2024 numri i PAE është 12 pedagogë; Numri i PAK 9 pedagogë, Nr. staf ndihmës akademik është 4;</td></tr> <tr> <td>- Për vitin 2022</td><td>- 2023 numri i PAE është 14 pedagogë; Numri i PAK 5 pedagogë; Nr. staf ndihmës akademik është 4;</td></tr> <tr> <td>- Për vitin 2021</td><td>- 2022 numri i PAE është 14 pedagogë; Numri i PAK 8 pedagogë, Nr. staf ndihmës akademik është 4.</td></tr> </table>	- Për vitin 2023	- 2024 numri i PAE është 47 pedagogë; Numri i PAK 1 pedagogë, sipas tabelës 6.1	- Për vitin 2022	- 2023 numri i PAE është 53 pedagogë; Numri i PAK 1 pedagogë; sipas tabelës 6.2	- Për vitin 2021	- 2022 numri i PAE është 60 pedagogë; Numri i PAK 5 pedagogë, sipas tabelës 6.3.	- Për vitin 2023	- 2024 numri i PAE është 12 pedagogë; Numri i PAK 9 pedagogë, Nr. staf ndihmës akademik është 4;	- Për vitin 2022	- 2023 numri i PAE është 14 pedagogë; Numri i PAK 5 pedagogë; Nr. staf ndihmës akademik është 4;	- Për vitin 2021	- 2022 numri i PAE është 14 pedagogë; Numri i PAK 8 pedagogë, Nr. staf ndihmës akademik është 4.
- Për vitin 2023	- 2024 numri i PAE është 47 pedagogë; Numri i PAK 1 pedagogë, sipas tabelës 6.1												
- Për vitin 2022	- 2023 numri i PAE është 53 pedagogë; Numri i PAK 1 pedagogë; sipas tabelës 6.2												
- Për vitin 2021	- 2022 numri i PAE është 60 pedagogë; Numri i PAK 5 pedagogë, sipas tabelës 6.3.												
- Për vitin 2023	- 2024 numri i PAE është 12 pedagogë; Numri i PAK 9 pedagogë, Nr. staf ndihmës akademik është 4;												
- Për vitin 2022	- 2023 numri i PAE është 14 pedagogë; Numri i PAK 5 pedagogë; Nr. staf ndihmës akademik është 4;												
- Për vitin 2021	- 2022 numri i PAE është 14 pedagogë; Numri i PAK 8 pedagogë, Nr. staf ndihmës akademik është 4.												

	Gjithashtu, nga vizita në Institucion na u vu në dispozicion e gjithë procedura e punësimit të personelit akademik PAE dhe PAK për DSHT. Po ashtu edhe kontratat e punës. <i>Referenca:</i> <i>Ref_052 - Procedura e Punësimit të Personelit PAE në UPT</i> <i>Ref_053 - Procedura e Punësimit të Personelit PAK në UPT</i> <i>Ref_065 - Praktikë e Punësimit të stafit akademik FGJM</i> <i>Ref_103 - Kontrata pune Stafi akademik PAK DSHT</i> <i>Ref_111 - Tabela përmbledhëse BSc. Ixhinieri Gjeomjedisi</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Programi i studimit ka një staf PAE bërthamë, i cili është aktiv që prej hapjes së këtij program studimi. Kjo tregon qëndrueshmëri të programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi. Gjatë shqyrtimit të dosjeve të personelit akademik qoftë PAE dhe PAK u konstatua që IAL i përmbush të gjitha detyrimet ligjore. <i>Referenca:</i> <i>Ref_103 - Kontrata pune Stafi akademik PAK DSHT</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni ka ndjekur procedura për rekrutimin e personelit akademik të cilat janë të reflektuara në Statutin e Universitetit dhe që ndiqen në mënyrë rigoroze nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Departamentet. IAL ka miratuar dhe zbaton një rregullore për rekrutimin e stafit, e cila ka për qëllim të përcaktojë kushte që duhet të plotësohen në rekrutimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. GVJ konstatoi që procedura e rekrutimit është në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe Kodin e Punës në RSH. Por, vlerësojmë se: - Sektori i Burimeve Njerëzore nuk ka përfaqësues në grupin e marrjes në punë për pedagogët e jashtëm, për të ndjekur ligjshmërinë juridike dhe procedurën administrative. - Pedagogët e brendshëm nuk plotësojnë dosjen e vetëvlerësimit. - Nuk përcaktohen pikët për kriteret e punësimit. Pikësimi bëhet subjektiv nga anëtarët e komisionit, pasi nuk është përcaktuar se sa pikë ka secili kriter. - Kur hapet thirrja për punësim, nuk përcaktohen se cilat janë pikët për intervistën me gojë dhe me shkrim. <i>Rekomandim:</i> <i>Vlerësojmë që forma e punësimit për pedagogët full time dhe part time në UPT të jetë më transparente. Çdo kriter duhet të jetë i përcaktuar qartë me pikët përkatëse. Gjithashtu, duhet të përcaktohen pikët për intervistën me gojë (ose % që zë intervista me gojë, kundrejt dosjes me dokumente)</i>

	<i>Referenca:</i> <i>Ref_065 - Praktikë e Punësimit të stafit akademik FGJM</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Nga vlerësimi i dokumentacionit, Institucioni ka siguruar dhe garantuar angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. Ndarja e ngarkesës mësimore është bërë nga drejtuesi i DSHT për secilin anëtar të stafit akademik në përputhje me kompetencat profesionale të secilit pedagog. Nga shqyrtimi i tabelave në dokumentacionin e paraqitur, shpërndarja e orëve të ngarkesës mësimore është e balancuar. <i>Referenca:</i> <i>Ref_044 - Praktikë e parashikimit të ngarkesës mësimore FGJM</i> <i>Ref_059 - Raporti i realizimit të Ngarkesës Vjetore Pedagog Departament FGJM</i> <i>Ref_021 - Udhëzues i rektoratit UPT për zgjedhjen e Drejtuesve të Grupeve</i> <i>Ref_022 - Procedura e Zgjedhjes së Drejtuesit të Grupit Mësimor</i> <i>Ref_048 - Marrëveshjet me industrinë dhe institucione</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Nga vizita në Institucion por edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e UPT është përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe çështjeve juridike. Kjo drejtori ka mbledhur, ruajtur dhe përditësuar çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në këtë program studimi si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. Këto të dhëna na u vunë në dispozicion gjatë vizitës tonë në Institucion. <i>Referenca:</i> <i>Ref_005 - Organigrama e UPT</i> <i>Ref_103 - Kontrata pune Stafi akademik PAK DSHT</i> <i>Ref_006 - Rregullore e brendshme FGJM</i> <i>Ref_008 - Rregullore e brendshme DSHT</i> <i>Ref_001 - Statuti UPT</i> <i>Ref_024 - CV e stafit akademik.</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në	Nga verifikimi i dokumentacionit, Institucioni ka nënshkruar marrëveshje me subjekte për ndjekjen e praktikave profesionale të studentëve të FGJM. Sipas referencës së Marrëveshjeve Institucionale të UPT, rezulton se ky institucion ka nënshkruar 304 marrëveshje bashkëpunuese në rang

dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	programi studimi për praktikat profesionale me institucione të tjera shtetërore, organizata, komunitetin e biznesit si edhe institucione të tjera të arsimit të lartë, ku është përfshirë edhe programi BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi. Koordinatori i programit të studimit, që është njëkohësisht edhe Drejtuesi i KPS ndjek dhe orienton studentët në praktikat profesionale që Institucioni ka nënshkruar për këtë program studimi. Nga dokumentacioni i vlerësuar, funksionet dhe detyrat e koordinatorit përcaktohen në “Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënës”. Koordinatori luan rolin e monitoruesit të punës për miradministrimin e programit dhe praktikave profesionale si edhe përmbushjen e objektivave të tij. Marrëveshjet institucionale janë pasqyruar në referencat më poshtë: <i>Referenca:</i> <i>Ref_048 - Marrëveshjet me industrinë dhe institucione</i> <i>Ref_046 - Marrëveshjet Institucionale U PT</i>			
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Në programin e studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, personeli mbikëqyrës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale është koordinatori i programit të studimit. Ky koordinator propozohet nga Drejtuesi i KPS. Nga biseda me koordinatorin na u pohua se ai angazhohet në ndihmën e studentëve për përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të studentëve për praktikën profesionale. <i>Referenca:</i> <i>Ref_010 - Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i> <i>Ref_020 - Vendimi i FGJM për ngritjen e KPS</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson pozitivisht personelin akademik që mbulon programin e studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, i cili përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e këtij programi studimi për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita në Institucion konstatoam se mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e veprimtarisë mësimore nuk janë të mjaftueshme. Kjo na u shpjegua se ka ardhur për shkak të rikonstruksionit të godinës së FGJM. <i>Gvj konstatoj se klasat dhe auditorët ku zhvillohej mësimi nuk plotësonin standardet bashkëkohore. Gjithashtu, Laboratorët nuk ishin plotësisht në funksion, ku pjesa më e madhe e pajisjeve ishin të ambalazhuara. Po kështu edhe biblioteka fizike nuk ishte në dispozicion.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref_066 - Relacion për infrastrukturën e FGJM</i> <i>Ref_107 - Leje ndërtimi për rikonstruksionin e godinës.</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita në Institucion u konstata se mjediset mësimore si klasa, laboratorë, nuk janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit. Kjo gjë nuk garanton realizimin e procesit mësimor praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. <i>Mungesa e teknologjisë në mjediset e mësimdhënies si edhe të laboratorëve, vjen për shkak të rikonstruksionit të godinës së FGJM.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref_066 - Relacion për infrastrukturën e FGJM</i> <i>Ref_107 - Leje ndërtimi për rikonstruksionin e godinës.</i> <i>Ref_105 - Modernizimi i Laboratorëve të DSHT</i> <i>Ref_050 - Informacion Laboratorët DSHT.</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita në Institucion nuk e patëm të mundur të shikonim Laboratorët apo mjediset e tjera, pasi çdo pajisje ishte e ambalazhuar. Aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi nuk ishin plotësisht në funksion për shkak të rikonstruksionit të godinës së FGJM. <i>Referenca:</i> <i>Ref_066 - Relacion për infrastrukturën e FGJM</i> <i>Ref_068 - Evidenca e laboratorëve në UPT</i> <i>Ref_050 - Informacion Laboratorët DSHT.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni i arsimit të lartë siguron pjesërisht laboratorë teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. Për shkak të rikonstruksionit të godinës së FGJM, laboratorët përkatës për këtë program studimi ishin pjesërisht funksional. Pajisjet dhe aparaturat e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi nuk ishin të vëna në dispozicion.

	Referenca: Ref_068 - Evidenca e laboratorëve në UPT			
Konkluzione	GVJ vlerëson që Standardi IV.2, ku Institucioni i arsimit të lartë duhet të vendosi në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit, përmbushet pjesërisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësim nxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga studimi i dokumentacionit, por edhe nga vizita në Institucion, GVJ vlerëson se literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. Kjo literaturë bazë dhe ndihmëse na u sqarua nga pedagogët e programit, por edhe nga studentët, që vihej në dispozicion çdo fillim viti akademik në format fizik ose elektronik. Referenca: Ref_064 - Shembull klase virtuale në platformën Google Classroom
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Nga vizita në Institucion na u pohua se Departamenti raporton në çdo fillim viti akademik përditësimin e literaturës me botime të reja dhe bashkëkohore. Referenca: Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi Ref_011 - Plani Mësimor PS Në BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga dokumentacioni i paraqitur, UPT ka në dispozicion një bibliotekë shkencore qendrore për të gjithë studentët e saj. Sipas të dhënave, biblioteka disponon 65570 tituj dhe 75 vende leximi. Ndërsa, biblioteka fizike e FGJM nuk është vënë në dispozicion studentëve, për shkak të rikonstruksionit të godinës. Megjithatë, studentët mund të kishin akses online në bibliotekën e UPT. Referenca: Ref_023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeomjedisi

	<i>Ref_103 - Rregullore e Bibliotekës Shkencore</i> <i>Ref_069 - Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës Shkencore 2021-2024</i> <i>Ref_070 - Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit si edhe vizitës në Institucion, GVJ vlerëson se UPT ka një bibliotekë të pasur me tituj për fusha të ndryshme. Biblioteka e UPT është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Ajo çfarë konstatuam ishte mangësia e Bibliotekës fizike të FGJM, për shkak të rikonstruksionit të godinës. <i>Referenca:</i> <i>Ref_070 - Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Nga dokumentacioni i paraqitur, UPT është lidhur me sistemin COBISS, i cili është një rrjet i gjerë bibliotekash ku studentët e programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi mund të aksesojnë online dhe të shfrytëzojnë katalogun e librave në distancë. <i>Referenca:</i> <i>Ref_075 - Biblioteka Digjitale</i> <i>Ref_094 - Rregullore e Bibliotekës Shkencore</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga vizita në Institucion, Biblioteka Qendrore e UPT ofron lidhje me internetin kabull ose wirelless, për ti mundësuar studentëve shfrytëzimin e katalogëve online. Ambientet ishin të pajisura me kompjuterë fizik që vendoseshin në dispozicion të studentëve. <i>Ndërsa biblioteka e FGJM nuk ishte në dispozicion, për shkak të rikonstruksionit të godinës.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref_070 Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka fizike e FGJM nuk ishte në dispozicion të studentëve. Megjithatë UPT ka Bibliotekën Qendrore Shkencore, e cila vihej në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. <i>Referenca:</i> <i>Ref_070 - Informacion mbi Bibliotekat në UPT</i> <i>Ref_094 - Rregullore Bibliotekës Shkencore</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për	Nga diskutimi me Përgjegjësen e Departamentit dhe stafin akademik na u pohua se ata bënin shpesh kërkesa për vëllime të reja tekstesh bashkëkohore Bibliotekës Qendrore të UPT-së.

cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	FGJM kishte bërë një përmbledhje të kërkesave dhe më pas ja kishte paraqitur bibliotekës. Biblioteka raportojnë për cilësinë e fondit fizik dhe fondit online, përditësimin dhe shkallën e shfrytëzimit të tyre nga personeli akademik dhe studentët e këtij program studimi. <i>Referenca:</i> Ref_069 - Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës Shkencore 2021 – 2024 Ref_097 - Praktikë mbi hartimin e Buxhetit në nivel njësie kryesore - bazë			
Konkluzione	GVJ vlerëson se programi i studimit përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies. Por, mjediset mbështetëse të mësim nxënies, si biblioteka apo mjedise të tjera të posaçme, nuk mund të shfrytëzohen për shkak të rikonstruksionit të godinës së FGJM. Megjithatë, studentët mund të shfrytëzojnë Bibliotekën Qendrore të UPT-së. Kështu që vlerësojmë se ky standard përmbushet kryesisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nga dokumentacioni i shqyrtuar, vlerësohet se UPT mban në formë të shkruar: regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike, si edhe regjistrin e lëshimit të diplomave. GVJ vlerëson se Sekretaria Mësimore administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. <i>Referenca:</i> Ref_006 - Rregullore e brendshme FGJM Ref_030 - Modeli i regjistrave në SM Ref_040 - Video tutorial për përdorimin e platformës BIT ALBANIA

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sipas RVB, UPT dhe FGJM administrojnë informacionin dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, personelit administrativ dhe të gjithë personave të angazhuar në realizimin e programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi. Nga takimi me specialistët e zyrës së Burimeve Njerëzore, konstatuam se dokumentacioni dhe procedurat e punonjësve, kontratat e punës si edhe hedhjen e çdo të dhëne në regjistrin themeltar ndiqeshin prej tyre. Sistemi i menaxhimit të UPT dhe FGJM ka siguruar akses të dedikuar në informacione e dokumente për gjithë personelin akademik dhe studentëve të programit të studimit. GVJ-së iu siguroi se secili përdorues ka një kod llogarie dhe një fjalëkalim fillestar, ku më pas secili përdorues mund ta menaxhonte në mënyrë të pavarur llogarinë e tij. <i>Referenca:</i> <i>Ref_040 - Video tuorial për përdorimin e platformës BIT ALBANIA</i> <i>Ref_081 - Rregullore e Sekretarisë Mësimore FGJM</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit me të cilin punon FGJM është BIT ALBANIA. Ky sistem ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Gjithashtu na u sqarua se FGJM ka përdorur edhe platformën Google Classroom për të krijuar klasat virtuale, apo për të kryer komunikime të tjera si për shembull: ngarkim detyrash kursi, projekte, njoftime etj. <i>Referenca:</i> <i>Ref_040 - Video tutorial për përdorimin e platformës BIT ALBANIA</i> <i>Ref_064 - Shembull klase virtuale në platformën Google Classroom</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Na u siguroi që sistemi BIT ALBANIA garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. <i>Referenca:</i> <i>Ref_040 - Video tutorial për përdorimin e platformës BIT ALBANIA</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ vlerëson pozitivisht faqen online të webit të UPT, në të cilën publikohen informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, në dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. Gjithashtu përdoren edhe platforma të tjera bashkëkohore si Facebook dhe Instagram. <i>Referenca:</i> <i>Ref_035 - Informimi i studentëve nëpërmjet platformave online</i> <i>Ref_036 - Webpage FGJM dhe DSHT në Facebook</i>

Konkluzione	GVJ vlerëson pozitivisht përmbushjen e standardit, ku institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e ka vënë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit BSc në "Inxhinieri Gjeomjedisi".			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Sipas dokumentacionit të RVB dhe referencave përkatëse, Institucioni ka miratuar çdo vit tarifat e shkollimit për programin e studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, në përputhje me VKM në fuqi. Tarifat janë miratuar me Vendim Bordi Administrativ, pasi kanë marrë mendimin paraprak të Senatit Akademik. Autoriteti përgjegjës për raportimin financiar është Administratori i UPT. Institucioni ka hartuar një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. <i>Referenca:</i> <i>Ref_001 - Statuti i UPT</i> <i>Ref_090 - Projekt Buxheti Afatmesëm 2021-2023 FGJM</i> <i>Ref_108 - Analizë financiare për nxjerrjen e kostos së programeve të studimit</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet	Sipas RVB, FGJM ka hartuar dhe aprovuar Planin Strategjik të fakultetit për periudhën 2018-2023. Në këtë plan strategjik është bërë një analizë e gjendjes aktuale dhe asaj strategjike. UPT nuk ka realizuar një plan financiar të dedikuar për programe specifike studimi. Gjithashtu, Njësia bazë përgjegjëse nuk ka një plan financimi të për programin e studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi. <i>Rekomandim:</i> <i>Rekomandojmë që DSHT duhet të përgatisë një plan financiar për programin e studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, në të cilin të përfshihen financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	<i>bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref_007 - Plani Strategjik i FGJM 2020-2024</i> <i>Ref_002 - Plani Strategjik i UPT 2019 – 2024</i> <i>Ref_097 - Praktikë mbi hartimin e Buxhetit në nivel njësie kryesore - bazë</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe RVB, vlerësojmë se UPT kryen periodikisht auditim, ku vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Sipas dokumentacionit dhe bisedave me specialistët e financës, raporti financiar periodik përmban në mënyrë të hollësishme pasqyrat financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit, të ardhurat e universitetit etj. <i>Referenca:</i> <i>Ref_005 - Organigrama e UPT</i> <i>Ref_001 - Statuti UPT</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Sipas dokumentacionit dhe RVB, buxheti i universitetit planifikon të gjitha shpenzimet dhe të ardhurat të nevojshme për mbarrëvajtjen e institucionit. Në Referencën 090 tregohen të gjitha shpenzimet e programit të studimit për vitet akademike 2021 – 2023 <i>Referenca:</i> <i>Ref_090 - Projekt Buxheti Afatmesëm 2021 – 2023 FGJM</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Nga dokumentacioni i paraqitur, na tregohet që UPT ka burime financiare të qëndrueshme. Raportohet se mesatarisht 66% e të ardhurave financohen nga shteti dhe rreth 34% e tyre nga vetë UPT. Vlerësojmë që kjo % nuk është e favorshme për garantimin e investimeve në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit të UPT-së dhe infrastrukturës së saj. Megjithatë, duke parë dokumentacionin, buxheti ka pësuar rritje deri në 10%. <i>Rekomandim:</i> <i>Për të rritur më tej cilësinë e mësimdhënies dhe infrastrukturës së Institucionit (me pasurimin me laboratorë, aparatura, libra apo mjete të tjera didaktike), sugjerojmë uljen e shpenzimeve të pa nevojshme.</i> <i>Referenca:</i> <i>Ref_091 - Tabela e të ardhurave dhe investimeve 2021 -2024</i> <i>Ref_092 - Lista e shërbimeve të ofruara për të tretë FGJM</i>

	<i>Ref_093 - Shërbimet e kryera për të tretë.</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson pozitivisht përmbushjen e standardit për garantimin e financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Për programin e studimit BSc në “Inxhinieri Gjeomjedisi”, GVJ konstaton se Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave si njësi kryesore në ofrimin e këtij programi dhe Departamenti i Shkencave të Tokës si njësi bazë e tij, kanë një bazë Rregullatore të mirë përcaktuar të të gjithë rrugëtimit të kandidatëve për studentë, studentëve ndjekës të programit dhe deri në diplomimin e tyre. Referuar Planit Strategjik të Departamentit të Shkencave të Tokës (dokumenti 009 në DVV) dhe Planit Strategjik të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave (dokumenti 007 në DVV), <i>(konstatohet se është i njëjti material, pavarësisht nga emri që mban dokumenti)</i> qëllimi i strategjisë është realizimi i dokumentit themelor që përcakton drejtimit, politikat dhe planet e veprimit e të menaxhimit të Departamentit të Shkencave të Tokës (DSHT), zhvillimin e tyre në perspektivë, në përputhje me zhvillimet e vendit dhe të ekonomisë Shqiptare, prioritetet e zhvillimit dhe objektivat për çdo prioritet. <i>Referenca:</i> <i>Ref 009 – Plani Strategjik i DSHP</i> <i>Ref 004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 010 – Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Referuar Rregullores së programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, neni 11 dhe neni 13 i saj, regjistrimet në këtë program bëhen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në vend. Në këtë program studimi kanë të drejtë të regjistrohen shtetas shqiptarë ose të huaj. GVJ konstaton se në të gjithë bazën rregullatore të paraqitur në DVV, Kandidatët për studentë dhe studentët që ndjekin jo vetëm këtë program studimi por edhe programet e tjera që ofrohen në UPT, kanë të drejta të barabarta në ndjekjen dhe frekuentimin programeve të studimit që ofrohen në këtë institucion. Sipas RVB, kriteret për programin e studimit BSc në ‘Inxhinieri Gjeomjedisi’ përcaktohen nga Departamenti i Shkencave të Tokës dhe pasi shqyrtohen, miratohen në Dekanatin e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave dhe në Senatin akademik të UPT. <i>Referenca:</i> <i>Ref 010 – Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i>

Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Referuar Rregullores së programit të studimit BSc në "Inxhinieri Gjeomjedisi", neni 9, ky program studimi ka si kriter kryesor pranimit Maturën Shtetërore, si dhe të gjitha përcaktimet në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Sipas nenit 13 të kësaj Rregulloreje, në këtë program studimi kanë të drejtë të regjistrohen shtetas shqiptarë dhe të huaj. Shtetasit e huaj duhet të përmbushin të gjitha detyrimet/kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni përkatës i Republikës së Shqipërisë si dhe detyrimet që janë të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave dhe Rregulloren e UPT. <i>Referenca:</i> Ref004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref 010 – Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Për këtë kriter, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe njësia bazë në të cilën ofrohet programi i studimit, kanë një bazë rregullatore në të cilën janë të përcaktuara qartë, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve (III. Pranimi i kandidatëve; neni 9 i Rregullores së PS); vlerësimi i dijeve dhe masa e frekuentimit të programit (IV. Zhvillimi i aktiviteteve, neni 16,17,18 i Rregullores së PS); kushtet e mbrojtjes së diplomës dhe provimit të formimit (V. Mbrojtja e diplomës/provimi i formimit, neni 19) Për sa i përket transferimit të studimeve apo njohjes së studimeve të mëparshme, referuar Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, kuotat për transferimin e studentëve dhe programe të dyta studimi nga brenda UPT apo edhe nga Institucione të tjera të arsimit të lartë në vend, përbëhen nga kuotat e paplotësuara nga regjistrimet e vitit të mëparshëm dhe kapacitetet që mund të krijohen, si rezultat i çregjistrimit të studentëve gjatë vitit akademik. Transferimet dhe programet e dyta të studimeve pranohen në fillim të çdo viti akademik, jo më vonë se fundi i javës së dytë të semestrit të parë. Transferimet nga cikli i parë pranohen në përputhje me Udhëzimet e Ministrisë së Linjës. <i>Referenca:</i> Ref 010 – Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ –së, gjatë vizitës në Institucion, ju bë me dije se Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, përpara fillimit të çdo viti akademik, nëpërmjet Zyrës së këshillimit të karrierës organizon takime informuese me maturantët, duke ju komunikuar atyre kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për çdo program studimi që ofron, me qëllimin e mirë informimit të çdo maturanti i cili dëshiron të jetë kandidat për student në një program të caktuar studimi.

	Në DVV, GVB ka paraqitur dokumentacion mbi aktivitetet informuese të zhvilluara nga Institucioni për të interesuarit që duan të ndjekin program studimi që ofrohet në UART. Duke shfletuar këto materiale, konstatohet se synimi i institucionit është që nëpërmjet këtyre aktiviteteve të bëjë të ditur - Programet e studimit që ofron - Kriteret e pranimit - Mundësitë për marrje burse - Mundësitë për mobilitet në kuadër të projekteve të ndryshme <i>Referenca:</i> <i>Ref 031 – Aktivitete Informuese mbi programet e studimit</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Referuar DVV dhe dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni në kuadër të plotësimit të këtij kriteri, vërehet se nuk ka ndonjë politikë apo ndonjë kriter të veçantë për pranimin e kandidatëve me aftësi të veçantë, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Propozimi për kuotat e pranimit për ciklin e parë dhe të dytë të studimit, vjen në mënyrë shkresore nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Pas njohjes me këtë shkresë, Rektori i UPT i kërkon Njësitë kryesore propozimet për kuotat për çdo vit akademik. Pasi merren nga çdo njësi propozimet e kuotave, bëhet miratimi i tyre në Senatin akademik të UPT dhe në Bordin e Administrimit të UPT dhe këto vendime përcillen në MAS. Sipas dokumentacionit 026 - Praktika e miratimit të kuotave të pranimit konstatohet se Fakulteti i Gjeologji Minierave për vitin akademik 2021-2022, ka parashikuar kuota për kandidatët për student me statusin jetim dhe për studentët e pakicave dhe shtresave të marginalizuara (rome dhe ballkano egjiptianë). Nuk ka parashikuar kuota për personat me aftësi të kufizuar. Gjithashtu konstatohet se në këtë vit akademik janë parashikuar kuota edhe për studente nga trojet shqiptare jashtë Shqipërisë.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në Raportin e Vlerësimit të brendshëm, deklarohet se UPT ka një politikë për dhënie e bursave, gjysmë-bursave dhe tarifave të reduktuara, për studentët me notë mesatare të lartë dhe për ata studentë me familje me probleme sociale. GVJ nuk gjeti në dosjen e vetëvlerësimit ndonjë dokument që të faktehet kjo politikë e këtij Institucioni apo ajo çka vetë Grupi i vlerësimit të brendshëm është shprehur duke i dhënë përgjigje këtij kriteri.
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se UPT harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, dhe diplomimin në programin e studimit. Të gjitha janë të parashikuara në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi.</i>

	GVJ beson se UPT ka politika edhe për studentët në nevojë dhe për studentët me familje me probleme sociale, por në DVV mungon një dokument i tillë ku të vërtetohet kjo politikë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Referuar RVB si dhe dosjes së Vetëvlerësimit, mbështetur edhe në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe të mësimdhënies në UPT, GVJ konstaton se Institucioni ka informacion të plotë dhe të qartë, informacion i cili është vendosur në dispozicion të studentëve duke ju bërë me dije kushte e kalimit në vitin pasardhës. Sipas nenit 37 të kësaj Rregulloreje, për programin Bachelor, studenti i vitit të parë kalon në vitin e dytë nëse ai ka marrë jo më pak se 50% të krediteve (30 kredite) të vitit të parë. Për programet e studimit të ciklit të parë, studenti i vitit të dytë kalon në vitin e tretë, nëse ai ka marrë jo më pak se 80 kredite. Student që nuk plotëson kriteret për të kaluar në vitin pasardhës ka këto të drejta dhe detyrime për lëndët jo kaluese: - I njihen të gjitha detyrimet e shlyera kur programet e lëndëve përkatëse janë të pranueshme për vitin në vazhdim - Mund të frekuentojë lëndët për të cilat është vlerësuar mbetës dhe është i detyruar të frekuentojë lëndët për të cilat ka detyrim frekuentimin - Duhet të shlyejë detyrimet e reja që lindin për shkak të ndryshimit të planit e programeve mësimore, nëse ka detyrim frekuentimin lëndë që janë zëvendësuar në këtë plan me lëndë të reja - Duhet të paguajë tarifën e shkollimit <i>Referenca:</i> Ref 004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstaton se UPT, ka politikë të qartë dhe të mirë menduar për studentët të cilët duan të studiojnë në programet që ofron ky Institucion duke kërkuar transferimin e studimeve nga një institucion tjetër i arsimit të lartë në vend. Kjo gjë Ju pohuar GVJ edhe gjatë takimeve të realizuara në vizitën në vend. GVJ shprehet se sipas Rregullores së Zhvillimit kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, neni 39. Universiteti Politeknik i Tiranës i ofron mundësinë të interesuarve për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, në fillim të vitit

	akademik, brenda UPT – së apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, publike ose private, vendase ose të huaja. Programet e studimit dhe detyrimet e shlyera në institucione të tjera njihen dhe ekuivalentohen nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm. Për njohjen dhe ekuivalentimin e krediteve angazhohet drejtpërdrejtë njësia bazë ose njësia kryesore, ajo njësi në të cilën është paraqitur kërkesa për transferimin e studimeve. Kjo Rregullore shprehet se Njësia kryesore ose njësia bazë parashikon në rregulloren e programit fushat e përafërta të studimit që lejohen për transferimin e studimeve. Në Rregulloren e programit nuk janë parashikuar fushat e përafërta të studimit që lejojnë studentët të transferojnë studimet e tyre. <i>Referenca:</i> <i>Ref 004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 010 – Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve të studentëve që ndjekin një program studimi në UPT paraqitet në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies. Sipas kësaj Rregulloreje, për të vlerësuar studentët, përdoret sistemi i vlerësimit me 10- nota. Nota 10 është vlerësimi maksimal dhe nota minimale kaluese është nota 5. Po sipas kësaj Rregulloreje, është shkruar shprehimisht se : në rastin e organizimit të moduleve të përbërë ku marrin pjesë disa disiplina, vlerësimi realizohet nëpërmjet provimeve të integruara ose shlyerjes së modulit me pjesë. Në të dyja rastet, vlerësimi përfundimtar do të shprehet nëpërmjet një note mesatare të ponderuar, ku merret në konsideratë vlerësimi dhe kreditet për çdo pjesë të shlyer. GVJ shprehet se forma e vlerësimit të studentëve është e pasqyruar edhe në syllabusin e lëndëve që përbëjnë planin mësimor të programit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi. Në syllabuset e lëndëve, forma e vlerësimit të studentëve është e ndryshme dhe lidhet me specifikën e lëndës. P.sh në syllabusin e lëndës Analizë matematike 1 vlerësimi i studentëve jepet si më poshtë: - 20% në modulin në mes të semestrit, - 10% në aktivizimin dhe plotësimin e detyrimeve semestrale, - 70% sipas provimit përfundimtar. Ndërsa tek syllabusi Gjeologji e Përgjithshme, student vlerësohet si më poshtë: - Lënda vlerësohet 80% sipas provimit përfundimtar dhe - 20% sipas rezultateve të kontrolleve. Parakusht për hyrjen në provim të kësaj lëndë është frekuentimi i seminareve nga studenti në masën 75% dhe frekuentimi i laboratorëve në masën 100%

	<i>Referenca:</i> Ref 004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref 023 - Syllabuset e lëndëve në PS BSc Inxhinieri Gjeomjedisi
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se Institucioni ka parashikuar dhe zbaton kriteret dhe procedurë të qartë për studentët në lidhje me punimin e diplomës dhe procesin e diplomimit të tyre. Punimi i diplomës është përcaktuar si në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe të mësimdhënies në UPT, dhe më i detajuar në Rregulloren e programit. Referuar Rregullores së programit të studimit BSc në inxhinieri Gjeomjedisi, në kreun V të saj, neni 19, është mirë përcaktuar Mbrojtja e diplomës/Provimi i formimit. Në këtë nen flitet për mënyrën e përgatitjes së punimit të diplomës; përcaktimin e temës së diplomës në bachelor; Udhëheqjen e diplomës; përmbajtjen e kontroleve, ku në total parashikohen 2 kontrole; mbrojtjen dhe vlerësimin e diplomës; kriteret e diplomimit, ku është përcaktuar që studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar 175 kredite të parashikuara në planin mësimor të programit të studimit. Komisioni i provimit, i cili përbëhet nga së paku tre anëtarë, përfaqësues të stafit akademik efektiv të Fakultetit të Gjeologji Minierave, anëtarë të cilët propozohen nga Departamenti i Shkencave të Tokës dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Provimi zhvillohet me shkrim dhe korrigjohet nga komisioni i provimit. Provimi vlerësohet me 5 kredite dhe vlerësimi i studentëve bëhet me notë. <i>Referenca:</i> Ref 004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT Ref 010 – Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, kreu V, neni 19
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu komunikua që UPT në përgjithësi dhe Fakulteti i Gjeologji Minierave në veçanti, marrin pjesë në të gjitha panairët e organizuara nga Ministria e Arsimit, por jo vetëm, për të promovuar programet që ofrohen në rang Universitetit dhe në rang fakulteti. Sipas përfaqësuesve të zyrës së sigurimit të cilësisë, në këto takime shpërndahen broshura informuese për të gjithë të interesuarit që duan të ndjekin një program studimi në UPT. GVJ ju komunikua gjithashtu se i gjithë Institucioni është i përfshirë në promovimin e programeve që ofron por duhet pranuar që interesi për të ndjekur një program studimi në UPT ka rënë. Kjo rënie shikohet qartë edhe në numrin e studentëve që ndjekin këtë program studimi. Në vitin 2022-2023 janë regjistruar 15 studentë, ndërsa në vitin 2023-2024 janë regjistruar 9 studentë.
Konkluzione	GVJ konstaton se në dispozicion të studentëve që ndjekin programin e studimit, BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, është vendosur një informacion i nevojshëm në lidhje me përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundimin e studimeve në këtë program.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ në lidhje me këtë kriter shprehet se për informimin e studentëve në lidhje me strukturën e organizimit të programit, pjesë e të cilës është edhe kohëzgjatja e tij, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave dhe Departamenti i Shkencave të Tokës, përdorin disa rrugë dhe mënyra komunikimi. Konstatohet se ka një bazë rregullatore si të programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, ashtu edhe të rregullores se zhvillimit kurikular dhe të mësimdhënies, rregullore e cila është për të gjithë programet që ofrohen në UPT. GVJ gjatë vizitës në institucion, u informuam se studentët informohen që në momentin që regjistrohen në këtë program studimi në sekretarinë mësimore se si është i organizuar programi i studimit. Informacion më të hollësishëm, studentët e marrin gjatë kontakteve me pedagogët, tutorët e tyre.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në lidhje me këtë kriter, GVJ në dosjen e vetëvlerësimit gjen material sesi Institucioni informon studentët në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit dhe veprimtaritë formuese. Sipas dokumentacionit (Ref 098 Fletë palosje informuese) studentët njihen me pikat kryesore të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave që janë: - Bursa studimi për programin Erasmus + - Mundësitë e punësimit në programet që ofron ky fakultet, pjesë e të cilit është edhe BSc në inxhinieri Gjeomjedisi; - Bursa për studentët me mesatare të lartë; - mundësinë për të ndjekur një program studimi të ciklit të dytë; - mundësinë për të ndjekur një shkollë doktrate; - mundësitë e licencimit të tyre pas përfundimit të programit të studimit, p.sh. mundësi licencimi në fushën e Mjedisit dhe Gjeomjedisit, etj. Ndërsa informacionin më të plotë për veprimtaritë formuese, GVJ ju tha se studenti e merr në syllabuset e lëndëve dhe sidomos në komunikimin e vazhdueshëm me pedagogun, i cili është përcaktuar nga Departamenti për një grup të caktuar studentësh. Çdo grup studentësh ka pedagogun mentor të tij. <i>Referenca:</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>Ref 098 - Fletë palosje informuese</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ iu komunikua se UPT në rang Universiteti ka një sërë marrëveshjesh institucionale që janë në funksion të studentëve edhe për punësimin e tyre. Konstatohet se disa prej këtyre marrëveshjeve nuk janë më funksionale dhe do sugjerohet që institucioni të gjente format dhe mënyrat për të shtuar listën e marrëveshjeve në funksion të këtij programi studimi. Në dokumentin 046 janë përfshirë institucionet e bashkëpunimit me të cilat UPT realizon praktikantët e studentëve dhe ka mundësi punësimi. Në dokumentin e fundit të kësaj liste, paraqitet tabela me institucionet me të cilat janë lidhur marrëveshje në kuadër të Erasmus +. Në këtë tabelë janë përfshirë 34 Universitete të huaja, nga të cilat vetëm për dy institucione/Universitete janë në fuqi marrëveshjet për vitet që vijnë, konkretisht: - Universiteti of West Attica (UNIWA) i përfundon marrëveshja më 2027; - 2. Politecnico i Torinos, i përfundon marrëveshja më 2024. <i>Referenca:</i> <i>Ref 046 - Marrëveshjet Institucionale UPT</i> <i>Ref 048 - Marrëveshjet me industrinë dhe Institucione.</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Siç jemi shprehur edhe më lart, në UPT ka disa mekanizma të cilat funksionojnë duke informuar studentët me gjithçka që lidhet me procesin mësimor dhe me programin e studimit. Një informacion të hollësishëm studentët kanë edhe për infrastrukturën në funksion të programit dhe bazën laboratorike në funksion të realizimit të programit. Gjatë vizitës në vend, për shkak të punimeve/rikonstruksionit që kishin filluar prej kohësh në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, GVJ nuk pati mundësi të shikonte bazën laboratorike në funksion të programit BSc Inxhinieri Gjeomjedisi. <i>Gjatë vizitës GVJ pa laboratorë që ishin përshtatur për këtë program studimi deri në përfundimin e ristrukturimit të godinës ku do të jenë laboratorët në funksion të programit.</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Për programin e studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, studentët e këtij programi kanë mundësi të përdorimit edhe të platformës BIT. GVJ ju tha gjatë vizitës në vend që aksesimi i çdo studenti në këtë platformë është i lehtë dhe realizohet duke përdorur emër përdoruesi (<i>user name</i>) dhe fjalëkalim (<i>password</i>) personal. Me përdorimin e kësaj platforme studentët njihen që në momentin që regjistrohen në programin e studimit.
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se ka informacion të plotë për studentët. Për bazën laboratorike dhe infrastrukturën në funksion të këtij programi nuk shprehet dot plotësisht pasi gjatë vizitës në vend nuk u njohën me këtë infrastrukturë laboratorike.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ shprehet se Informacionin për këtë pikë e mori nga takimi me departamentin dhe me Sekretarinë mësimore. Referuar tabelës Nr. 23 (bashkangjitur RVB), ku paraqiten të dhënat për studentët e diplomuar, rezulton se për periudhën 2022-2024 numri total i të diplomuarve është 68 studentë. Sipas të dhënave në Sekretarinë mësimore, në vitin 2022 janë 20 studentë të diplomuar, ndërsa në vitin 2023 janë 25 studentë të diplomuar. Referuar materialit të paraqitur në DVV, (Ref 075 Raporti i aktivitetit mësimor të DSHT), i cili flet për raportimin vjetor për veprimtarinë e kryer për vitin akademik 2022-2023 të Departamentit të Shkencave të Tokës, dhe sipas tabelës Nr. 14/1 (Hyrjet dhe daljet sipas programeve të studimit), numri i të diplomuarve për programin BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi në vitin 2023 është 20 studentë. <i>Referenca:</i> <i>Ref 075 - Raporti i aktivitetit mësimor të DSHT</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ shprehet se informacioni për këtë pikë në DVV është i cunuar. Po ti referohesh përgjigjes që ka dhënë Grupi i vlerësimit të brendshëm për këtë program, përgjigja për këtë kriter është marrë edhe duke pasur si referencë materialin Ref 075 (Raporti i aktivitetit mësimor të DSHT). Referuar këtij materiali, GVJ konstaton se, sipas të dhënave për vitin akademik 2022-2023, vit në të cilën është përqendruar Institucioni kur ka përgatitur këtë raport/analizë, mungojnë të dhënat për: - Gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet (tabela Nr. 10) - Është paraqitur numri i studentëve të regjistruar në programin BSc në Inxhinieri gjeomjedisi (45 në total) por nuk ka të dhëna sa është nuri i studentëve të shkëlqyer dhe sa është numri i studentëve përsëritës (Tabela nr. 13 – Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve) - Nuk ka të dhëna për numrin e studentëve të çregjistruar dhe transferuar (Tabela Nr. 14) - Nuk ka të dhëna për përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindja e atyre që diplomohen (Tabela Nr. 14/2)

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





	- Nuk ka të dhëna për vlerësimin e përgjithshëm mbi cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi (Tabela Nr. 14/3) Në DVV është paraqitur si material referues materiali 045 (Raport i analizës mësimore Staf Departament). Në këtë material nuk flitet fare për statistika për studentët e regjistruar në këtë program studimi, të diplomuar apo të transferuar. GVJ gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore mori të dhënat e mëposhtme për këtë program studimi: <table border="1"> <tr> <td>Viti akademik 2021</td><td>2022 – 28 studentë të regjistruar – 3 të çregjistruar</td></tr> <tr> <td>Viti akademik 2022</td><td>2023 – 15 studentë të regjistruar – 1 i çregjistruar</td></tr> <tr> <td>Viti akademik 2023</td><td>2024 – 9 studentë të regjistruar</td></tr> </table> <i>Referenca:</i> <i>Ref 045 (Raport i analizës mësimore Staf Departament)</i> <i>Ref 075 - Raporti i aktivitetit mësimor të DSHT</i> <i>Minutat e vizitës në vend</i>	Viti akademik 2021	2022 – 28 studentë të regjistruar – 3 të çregjistruar	Viti akademik 2022	2023 – 15 studentë të regjistruar – 1 i çregjistruar	Viti akademik 2023	2024 – 9 studentë të regjistruar
Viti akademik 2021	2022 – 28 studentë të regjistruar – 3 të çregjistruar						
Viti akademik 2022	2023 – 15 studentë të regjistruar – 1 i çregjistruar						
Viti akademik 2023	2024 – 9 studentë të regjistruar						
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ konstaton se të dhënat për studentët ruhen në Sekretarinë mësimore të Fakultetit të Shkencave të Tokës. Në këtë fakultet funksiononte sistemi i brendshëm i informacionit në formë elektronike Bit Albania. GVJ ju komunikua se këto të dhëna janë të sigurta dhe të verifikueshme për personat e autorizuar, duke pasur parasysh mos kallëzimin e të dhënave sensitive të cilat mund të keq menaxhohen.						
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Në DVV deklarohet se të dhënat për studentët dhe statistikat për to, janë objekt kontrolli i përvitshëm nga strukturat përgjegjëse të UPT, nga kontrolli i të cilave realizohen raportimet përkatëse në strukturat drejtuese. GVJ tërheq vëmendjen që të dhënat për studentët të jenë të plota dhe të sakta, pasi na rezultojnë se mungon informacioni bazik mbi to (Referuar dok 075 në DVV, të dhënat për vitin akademik 2022-2023 i Departamentit të Shkencave të Tokës) <i>Referenca:</i> <i>Ref 075 Raporti i aktivitetit mësimor të DSHT</i>						
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e	Ashtu siç jemi shprehur edhe më sipër, në DVV por edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ iu komunikua se ka Raporte analitike, mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, etj. Në materialin tip të paraqitur në DVV, (075) të dhënat nuk janë të plota dhe janë paraqitur edhe tabela të cilat nuk kanë asnjë të dhënë për këtë fakt.						

duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Referuar Raportit të vlerësimit të brendshëm të programit të studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, Tabelave në fund të këtij raporti, shprehemi për këtë pikë sa më poshtë: Sipas tabelës Nr. 21 cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve paraqitet - Vitit akademik 2021-2022 – të regjistruar për herë të parë në vitin e parë, janë 22 studentë me notë mesatare 7.57 - Vitit akademik 2022-2023 – të regjistruar për herë të parë në vitin e parë, janë 15 studentë me notë mesatare 7.5 - Vitit akademik 2023-2024 – të regjistruar për herë të parë në vitin e parë, janë 9 studentë me notë mesatare 7.5 Në këtë tabelë mungojnë të dhënat për studentët e transferuar sipas viteve, sipas tabelës 23 në programin e studimit BSc në “Inxhinieri Gjeomjedisi”, për periudhën 2022-2024, numri total i të diplomuarve është 68; numri i të punësuarve (në përputhje me diplomën) është 18 dhe numri total i të punësuarave (jo në përputhje me diplomën) është 10. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit, Tabelat bashkëlidhur tij</i> <i>Ref 075 - Raporti i aktivitetit mësimor të DSHT</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se UPT ruan të dhëna bazike në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Duhet të tregohet më kujdes në të dhënat që paraqiten në raportimet e Departamenti të Shkencave të Tokës, pasi të dhënat janë të paplota.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në Raportin e vlerësimit të brendshëm, hartuesit e tij shprehin se studentët në UPT janë të përfshirë në organet vendimmarrëse dhe këshilluese. Ky fakt na u pohua edhe gjatë vizitës në institucion. Referuar dokumentacionit 076 (Rezultatet e zgjedhjeve për Senatën akademik), në Vendimin Nr. 22, datë 07.08.2020 “Për shpalljen e kandidatëve fitues të zgjedhjeve për anëtarë të Senatit akademik në Universitetin Politeknik të Tiranës”, vërejmë se përfaqësues të Senatit Akademik janë 4 studentë.

	GVJ pohon se studentët janë pjesë edhe e këshillave të programeve të studimit në Departamentin e Shkencave të Tokës. Referuar dokumentit 020 – vendimi i DSHT për ngritjen e KPS, vërehet se në miratimin e Këshillave të Programeve të Studimit për vitin akademik 2023-2024, në përbërje të këtyre këshillave për programet e studimit që ofrohen në Departamentin e Shkencave të Tokës, pjesë e të cilit është edhe programi i studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, janë edhe studentët e programit përkatës. Për programin BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, përfaqësues është studenti G.A. Gjithashtu GVJ pohon se pjesë e Grupit të vlerësimit të brendshëm të programit është dhe një studente, e cila ishte pjesë edhe e takimit që realizoi GVJ në Institucion me GVB-në. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref 076 - Rezultatet e zgjedhjeve për Senatin akademik</i> <i>Ref 020 - Vendimi i DSHT për ngritjen e KPS</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	GVJ shprehet se përgjigjen për plotësimin e këtij kriteri e mori në mënyrë të tërthortë gjatë vizitës në vend, si në takimin e Grupin e vlerësimit të brendshëm, pjesë e të cilit ishte edhe studentja, ashtu edhe me strukturat e tjera të Institucionit. Në fakt, Institucioni duhet të punojë më shumë për të nxitur studentët që të japim mendime dhe propozime konkrete për atë çka duhet të rregullohet si në funksionimin si duhet të programit të studimit ashtu edhe në veprimtaritë kërkimore. Në raportin e vlerësimit është paraqitur një material, ku Institucioni tregon një praktikë në gjuhën gjermane të përfshirjes së studentëve të UPT në veprimtari kërkimi (në fakt është vetëm një student me initiale I. M) <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref 076 - Rezultatet e zgjedhjeve për Senatin akademik</i> <i>Ref 020 - Vendimi i DSHT për ngritjen e KPS</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Nga Njësia e Sigurimit të cilësisë, GVJ-së gjatë vizitës në Institucion ju pohua se kjo Njësi shpërndan pyetësor për studentët duke synuar të marri prej tyre opinione në lidhje me programin e studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi. Qëllimi i pyetësorit është tu japë mundësi studentëve të shprehin mendimin e tyre mbi procesin mësimor dhe personelin akademik të programit si dhe të përcjellin pranë autoriteteve të UPT shqetësime specifike. GVJ gjykon se Institucioni përdor mekanizma për të thithur mendimin e studentëve në lidhje me programin e studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi. Pyetësori në vetvete ndihmon autoritetet drejtuese për të krijuar një panoramë të çështjeve apo problematikave që kërkojnë zgjidhje.



Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Në RVB është paraqitur një praktikë që ndiqet nga NJSBC për shpërndarjen e pyetësorit të studentëve. Gjithashtu GVJ ju komunikua se Njësia, në praktikën e saj të punës ka edhe raportin në lidhje me pyetësorët e studentëve. Në DVV është paraqitur raporti, (Ref 099 - Raport mbi anketimin studentor viti akademik 2021-2022 - sem 1). Ky raport është përgatitur nga Drejtoria e Sigurimit të brendshëm të cilësisë në UPT. GVJ shprehet se rubrikat që përbëjnë raportin janë të ndërtuara mirë, të detajuara, në mënyrë të atillë që Drejtoria e Sigurimit të cilësisë të mund të marrë një feedback të plotë dhe të qartë nga procesi i anketimit, për të përcjellë në Rektorat shqetësimet apo kërkesat që kanë studentët që ndjekin programet në UPT. Raporti përfshin në rubrikat e tij: - Bazën ligjore (Ligjin e Arsimit të Lartë; Kodin e cilësisë së Arsimit të Lartë) - Organizimin e pyetësorit (Qëllimi i tij; Hartimi i pyetjeve dhe kriteret e vlerësimit) - Sistemi elektronik i pyetësorit (Gjenerimi i të dhënave; anonimati i studentit) - Rezultatet e anketimit (Metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave; Pjesëmarrja në anketim) - Evidentimi i problematikave në rang institucioni - Vlerësimet sipas fakulteteve dhe programeve të studimit (Fakultetet pjesë e anketimit; përcaktimi i anketimeve të pavlefshme; kriteret e vlerësimit sipas Fakulteteve/programeve të studimit; rezultate për çdo fakultet/program studimi; problematikat dhe rekomandimet për përmirësimin e treguesve të ulët për çdo fakultet/program studimi) - Vlerësimet e pedagogëve (të dhëna të përgjithshme; rankimi i pedagogëve; rekomandimet dhe propozimet për përmirësimin e treguesve të ulët) - Vlerësimet e pedagogëve - Anekset për pyetësorin e 6 fakulteteve <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref 099 - Informacion për studentët për plotësimin e pyetësorit të lëndëve</i>			
Konkluzione	GVJ shprehet se UPT ka përfshirë dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. Studentët janë pjesë e Senatit akademik, janë pjesë e Grupeve të vlerësimit të brendshëm duke sjellë frymën dhe mendimet e tyre në institucionet drejtuese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ-së gjatë vizitës në institucion ju pohua se i gjithë Fakulteti i Gjeologji Minierave, së bashku me Departamentin e Shkencave të Tokës, departamenti përgjegjës për këtë program studimi, janë në shërbim dhe në funksion të studentëve. Referuar DVV dhe Raportit të vlerësimit të brendshëm, në shërbim të studentëve janë Drejtoria e Kurikulave me 2 sektorët e saj (Sektori i Kurikulave; Sektori i procesit mësimor) dhe Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit që ofron shërbimin e karrierës dhe Alumnit. Në DVV paraqitet dokumenti 032 – Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës, në të cilën është paraqitur një raport përmbledhës i aktiviteteve të Zyrës së karrierës për periudhën 2022-2023-2024 Më poshtë, GVJ paraqet disa nga aktivitete e bëra nga kjo Zyrë, ku janë përfshirë studentët e UPT-së, si: - Plani kalendarik i aktiviteteve për vitin akademik si dhe Guida studentore 2022-2023-2024 - Prezantimi për fillimin e vitit akademik me studentët e vitit të parë “Bachelor” 22-23 - Zhvillohet takimi për “Internship programme of German Business” për vendet e Ballkanit perëndimor, data 28.10.2022. - Publikim në Web-in e Fakultetit nga Shoqata Sportive UPT, datë 27.10.2022 - Workshop ne Zyrën e Karrierës së bashkisë Tiranë, më datë 13.01.2022 - Përgatitje për ditën e informimit të maturantëve (2023-2024), realizuar më datë 10.01.2023 - Për publikim në faqen e Fakultetit Platforma praktika.al 10.02.2023 - Datamine – FGJM organizon takim promovues mbi programin ‘DATAMINE’, datë 18.04.2023, etj. <i>Referenca</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref 032 – Aktivitete të organizuara nga Zyra e Karrierës,</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me	Ashtu siç jemi shprehur edhe më sipër, GVJ pohon që në funksion të studentëve të programit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi janë të gjitha strukturat e Departamentit të Shkencave të Tokës, të Fakultetit të Gjeologji Minierave dhe të krejt Universitetit Politeknik të Tiranës. Strukturat në funksion të studentëve kanë edhe bazën rregullatore të tyre.

procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sipas Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe mësimdhënies në UPT, organizimi dhe menaxhimi i çdo programi studimi në UPT, në nivel njësie bazë/Departamenti, bëhet nga Këshilli i Programit të Studimit. Në përbërje të këtij këshilli është edhe një student i cili përzgjidhet nga Departamenti i Shkencave të Tokës, si Departamenti përgjegjës për ofrimin e programit të studimit. Po sipas kësaj Rregulloreje, me propozim të Drejtuesit të departamentit caktohet koordinatori i programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe zhvillimin e praktikave profesionale në përputhje me rezultatet e të nxënit. GVJ shprehet se UPT si një institucion me përvojë të gjatë në fushën e ofrimit të programeve të studimit të tre cikleve, ka një sistem të mirë organizuar në funksion të procesit mësimor. Rol të veçantë këtu luan edhe Sekretaria mësimore e cila me shërbimet që ofron, është në funksion të studentëve. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref 004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ realizoi takim sipas agjendës, edhe me Zyrën e Karrierës. GVJ gjatë takimit ju prezantua puna e kësaj zyre. Në Raportin e vlerësimit të brendshëm, GVB shprehet se kjo zyrë shërben si urë lidhëse e Institucionit dhe shërbimeve që ofron me studentët. Siç jemi shprehur edhe më lart, pjesë e Dosjes së Vetëvlerësimit është edhe aktiviteti i Zyrës së karrierës për periudhën 2022-2023-2024. Referuar Rregullores së programit të studimit, qëllimi i kësaj rregulloreje është formimi i një figure profesionale të inxhinierit me kulturë shumë disiplinore dhe me koncepte profesionale zbatuese në drejtim të njohjes, parandalimit dhe mënjanimi të fenomeneve që shkaktojnë prishjen dhe ndotjen e gjeomjedisit, si dhe të impianteve dhe proceseve për trajtimin dhe përpunimin e mbetjeve. <i>GVJ konstaton se ky objektivi primar është një orientim për studentin në lidhje me procesin mësimor që do të ndjekë gjatë shkollimit të tij në këtë program studimi.</i> <i>Referenca</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm të programit</i> <i>Ref 004 – Rregullore e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT</i> <i>Ref 010 – Rregullore e PS BSc në Inxhinieri Gjeomjedisit.</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ ju komunikua që nuk është ngritur dhe nuk funksionon sistemi i ndjekjes së studentëve pas diplomimit të tyre në këtë program studimi. Ky fakt është deklaruar edhe në raportin e Vetëvlerësimit, ku GVB shprehet se: <i>...po punohet për të ngritur shoqatën Alumni/ae të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave.</i>

studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Sipas përfaqësuesve të Zyrës së karrierës dhe Alumni në takimin që realizuan me GVJ gjatë vizitës në vend, u deklarua se kjo Zyrë ka realizuar anketim të studentëve që kanë mbaruar studimet në këtë program studimi dhe rezulton se 70% e të anketuarve janë të punësuar; 50% janë të punësuar jo në profesion.			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se UPT si Institucion qëndror ka procedura e njësi të posaçme si Zyra e këshillimit të karrierës, Sekretaritet Mësimor të fakulteteve, të cilat angazhohen për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave duhet të punojë për gjurmimin e studentëve të tij të diplomuar nga të cilët mund të marri feedback për organizimin e programit të studimit dhe përputhjen e tij me tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Referuar Dosjes së Vetëvlerësimit dhe raportit të Vlerësimit të brendshëm, GVJ shprehet se për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme në funksion të mësimdhënies, UPT nuk ka një manual të dedikuar për këtë qëllim. Pavarësisht kësaj, ky Institucion deklaron se në planin strategjik për vitin 2019-2024 <i>synon të jetë lider në drejtim të përdorimit të IT në të gjithë veprimtarinë e tij duke mbështetur përpjekjet për zhvillimin e infrastrukturës dixhitale në shërbim të mësimi me pikësynim rritjen e përdorimit të software për zhvillimin profesional të personelit akademik dhe të studentëve.</i> GVJ vlerëson synimin e këtij Institucioni për të arritur atë që deklaron, por nuk mund ta faktojë se si do arrihet ky synim pasi në dosjen e vetëvlerësimit mungon dokumenti 002 – Plani strategjik i UPT 2019-2024 <i>GVJ vlerëson se sistemi BIT, i cili është në shërbim të sekretarisë mësimore është një mënyrë e mirë digitalizimi dhe është në shërbim të studentëve me mundësitë që ofron.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	GVJ shprehet se Universiteti Politeknik i Tiranës është një nga Institucionet e para të arsimit të lartë në vend dhe si i tillë, ndër vite, ka kontribuar duke përgatitur inxhinierë në degët më të rëndësishme të industrisë. Staf i akademik i UPT por edhe i Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave si njësi kryesore e programit të studimit, BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, është i kualifikuar, me tituj dhe me grada dhe me përvojë në mësimdhënie. Programi i studimit në Inxhinieri Gjeomjedisi, edhe pse është një program i ri në tregun shqiptar, ofrohet nga një staf i kualifikuar në këtë fushë dhe është një tregues pozitiv për mësimdhënien dhe studentët. GVJ gjithashtu pohon se gjatë vizitës në Institucion, këtij Grupi ju tha se analiza e kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike për realizimin e këtij programi, ishte një analizë që bëhej në Departamentin e Shkencave të Tokës.
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	GVJ shprehet se gjatë vizitës në Institucion u realizua takimi edhe NJSBC dhe gjatë këtij takimi ndër të tjera u pohua që kjo Njësi realizon pyetësorë me studentët për të thithur prej tyre mendimin kritik për përmirësim të procesit të mësimdhënies por edhe shërbimeve që ju ofrohen studentëve. Kjo njësi realizon edhe një raport me të dhënat nga përpunimi i pyetësorëve të studentëve dhe këtë raport e paraqet në Dekanat duke nxjerrë pikat e forta dhe pikat e dobëta të anketimit të studentëve.

	Anketimi realizohet online, ku çdo student kishte mundësi plotësimi nëpërmjet adresës së tij të email. Ashtu siç është shprehur edhe në dokumentin e paraqitur në DVV, Ref 061- Raport mbi anketimin studentor Viti akademik 2021-2022 (Sem I) qëllimi i këtij pyetësi është krijimi i një panorame të problematikave në UPT, duke u fokusuar tek perceptimi i studentëve në lidhje me Universitetin, Fakultetin, programin e studimit ku ata studiojnë dhe pedagogët e tyre, për të mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike duke vazhduar traditën e ekselencës e duke konsoliduar reputacionin kombëtar e rajonal. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Minutat gjatë vizitës në IAL</i> <i>Ref 061 - Anketimi studentor – Pyetësi dhe Raporti</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ ju pohua e Drejtoria e Kurikulave në nivel Institucioni, ka si bazë të punës së saj edhe përputhshmërinë e programit të studimit me standardet e cilësisë. Ka një Rregullore të zhvillimit kurikular dhe mësimdhënies në UPT, e cila i ka të përcaktuara të gjithë praktikën që ndiqet për zhvillimin dhe menaxhimin e programeve të studimit dhe të procesit mësimor në tërësi. Siç jemi shprehur edhe më sipër, Njësia e Sigurimit të Cilësisë monitoron sigurimin e cilësisë në mësimdhënie edhe nëpërmjet pyetësorit të studentëve. Monitorimi i procesit të mësimdhënies, realizohet edhe nëpërmjet kontrolleve që bën Zyra e NJSBC për organizimin e mësimin, sidomos në pedagogët e rinj. Të gjitha format bëhen publike dhe me rezultatet e monitorimit njoftohet Departamenti si njësi bazë dhe Fakulteti si njësi kryesore. <i>Referenca</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref 004 – Rregullore e Zhvillimit Kurikular dhe Mësimdhënies në UPT</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Gjatë takimit me GVB por edhe me stafin akademik, GVJ arrin në konkluzionin që Institucioni nxit përmirësimin e mësimdhënies. Shembull i tillë është mobiliteti i stafit të këtij programi nëpërmjet programeve të ndryshme ndërkombëtare. Duke parë emrat e stafit në projektet ndërkombëtare si pjesëmarrës në to, të krijohet përshtypja sikur janë vetëm dy apo tre personel akademik që merr pjesë në të tilla projekte. Në fakt, GVJ iu pohua se Institucioni i fton dhe nxit të gjithë pedagogët të përfshihen në këto projekte, pasi shkëmbimi dhe sjellja e eksperiencave do ishte një tregues i mirë për promovimin e praktikave më të mira ndërkombëtare.
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se Institucioni ndjek politika për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies. Këto politika konsistojnë në</i>



	monitorimin e procesit mësimor kryesisht në këqyrjen konkrete të një ore mësimi sidomos tek pedagogët e rinj, pyetësorit të studentëve, mobilitetit të stafit të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ shprehet se në UPT ka një strukturë të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Referuar Organigramës së UPT, shikohet qartësisht se Drejtorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila varet nga Zv Rektori i UPT, ka në përbërje të saj Sektorin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (me dy specialistë) dhe Sektorin e Statistikës dhe Informacionit. Referuar RVB, Grupi i vlerësimit të brendshëm shprehet se rrjeti i cilësisë në UPT përbëhet nga : - Njësia qendrore e sigurimit të Cilësisë e ngritur në Rektoratit e UPT - Njësitë e Sigurimit të Cilësisë në çdo njësi kryesore të UPT Në rregulloren e Fakultetit të Gjeologji Minierave (FGJM), në Kreun X të saj, flitet për vlerësimin e cilësisë në rang fakulteti. Fakulteti është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Njësia e Sigurimit të brendshëm të cilësisë në Fakultet koordinon veprimtarinë e sigurimit të cilësisë në departamente; planifikon organizimin periodik të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit në koordinim me Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT; harton në bashkëpunim me Dekanatin, planin vjetor të veprimit për përmirësimin e cilësisë dhe harton raportin vjetor të cilësisë. Gjithçka më sipër ju pohua GVJ në takimin në Institucion. <i>Referenca:</i> <i>Ref 005 - Organigrama e UPT</i> <i>Ref 006 - Rregullorja e FGJM</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku	Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është funksional në UPT. Ky fakt iu komunikua GVJ gjatë vizitës në Institucion si nga përfaqësuesit e Zyrës së NJSBC, ashtu edhe nga anëtarët e GVB dhe drejtuesi i Departamentit. GVJ nisur nga DVV dhe rregullorja e programit, konstaton se: Përmirësimi i mësimdhënies; implementimi i metodave të reja në përputhje me natyrën dhe specifikën e programit të studimit; rritja e

përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	vetëdijes së personelit akademik dhe e studentëve për cilësinë në programet e studimit që ofrohen; mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit në mënyrë periodike të aftësive të mësimdhënies, janë përgjegjësi e drejtpërdrejtë e fakultetit dhe e Dekanatit të këtij fakulteti. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref 006 - Rregullorja e FGJM</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Universiteti Politeknik i Tiranës, me programet që ofron i është nënshtruar disa herë procesit të vlerësimit në kuadër të akreditimit si atij Institucional, ashtu edhe të programeve të studimit të të dy cikleve. Besojmë dhe shpresojmë se procese të tilla janë të shëndetshme për Institucionin pasi vënë në punë mekanizmat për mirëfunksionimin e tij dhe jo vetëm. Ri akreditimi institucional me vlerësimin maksimal, sipas vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 01, datë 07.01.2022 ‘Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti Politeknik i Tiranës’, është një tregues i përputhshmërisë së shkallës së plotësisë të Standardeve Shtetërore të Cilësisë me vlerësimin në kuadër të akreditimit të këtij institucioni. <i>Referenca</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref 018 - Vendimi i Bordit për akreditimin e UPT</i>
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Ashtu siç jemi shprehur edhe më lart. Në Rregulloren e Fakultetit të Gjeologji Minierave, në kreun X të saj janë parashikuar disa nene në funksion të vlerësimit të cilësisë. Sipas kësaj rregulloreje, fakulteti është përgjegjës për procesin e mësimdhënies. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit që ofrohen në këtë Fakultet. Studenti informohet në fillim të vitit akademik, me përmbajtjen, detyrimet, metodologjinë e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe kompetencave të cilat janë të parashikuara në syllabusin e lëndës. Departamenti zhvillon kontrolle në auditor për procesin e mësimdhënies. Kontrolle realizohen edhe nga titullari i lëndës tek personeli akademik, i cili përfshihet në mësimdhënie. Të gjitha sa më sipër janë tregues të qartë për të nxitur arritje sa më të mira në programin e studimit. <i>Referenca</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref 006 - Rregullorja e FGJM</i>
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se Institucioni ka hartuar një bazë rregullatore në të cilën ka parashikuar politika për sigurimin e cilësisë së programit të studimit.</i>
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet Përmbushet pjesërisht Përmbushet kryesisht Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ, në bazë të dokumentacionit të paraqitur në Dosjen e vetëvlerësimit, mbështetur edhe në Raportin e vlerësimit të brendshëm si dhe vizitës dy ditore në Institucion, shprehet se programi i studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi është në mbikëqyrje dhe nën kujdesin e Departamentit të Shkencave të Tokës (DSHT), së njësia bazë përgjegjëse për mbarëvajtjen e tij. Këtë pohim e mbështesim edhe në Rregulloren e Departamentit, e cila ka të përcaktuar strukturën e DSHT, mënyrën e funksionimit të tij si dhe kriteret dhe procedurat për zhvillimin dhe menaxhimin e procesit mësimor. Ky Departament është i organizuar dhe i strukturuar mbi bazë të grupeve mësimore-kërkimore-shkencore. Grupi mësimor –kërkimor organizon punën për hartimin e planit mësimor dhe të programeve të lëndëve, mbikëqyr respektimin e planeve dhe programeve mësimore; ndjek ecurinë e procesit mësimor për lëndët e mbuluara nga pedagogët e grupit mësimor- kërkimor; dhe në përfundim të çdo semestri raporton tek Përgjegjësi i Departamentit për realizimin e programit mësimor. Programi i studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi ka një koordinator programi, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat formuese të tij. Koordinator i programit (neni 9 në Rregulloren e DSHT) në detyrat e tij ka të përcaktuar sa më poshtë: - Realizimin e procesit mësimor - Bashkëpunon dhe koordinon aktivitete me strukturat përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit në përputhje me rregulloren e Departamentit dhe rregulloren e Fakultetit - Siguron që plani mësimor dhe syllabuset e programit të studimit të jenë të përditësuara në fillim të çdo viti akademik - Siguron që materialet didaktike të jenë të disponueshme dhe të aksesueshme për studentët. Për gjithçka sa më sipër por edhe për detyra të tjera të cilat janë të përcaktuara në bazën rregullatore të fakultetit por edhe të Departamentit, raportohet tek Përgjegjësi i Departamentit, i cili rast pas rasti merr masat konkrete sipas problematikave të raportuara. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i>



	<i>Ref 008 - Rregullorja e brendshme e DSHT</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, realizimi i programit mësimor, ndjekja dhe frekuentimi i tij nga studentët e çdo programi studimi, janë në vëmendjen e Departamentit të Shkencave të Tokës, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi. Referuar Dosjes së vetëvlerësimit të paraqitur nga GVB, në Rregulloren e Departamentit të Shkencave të Tokës, në nenin 14 të saj, shkruhet shprehimisht: <i>Departamenti bën politikën dhe strategjinë e zhvillimit aktual dhe perspektiv të tij. Harton planet dhe programet mësimore dhe bën sugjerime dhe propozime për përmirësimin e përmbajtjes dhe strukturës së tyre.</i> Në këtë rregullore është përcaktuar qartë funksionimi i Departamentit (Kreu III). Ky Departament organizohet dhe funksionon mbi bazën e grupeve mësimore kërkimore, në përbërje të të cilëve janë 5(pesë) personel akademik me kohë të plotë. Grupi mësimor, detyrat dhe përgjegjësitë e tij janë të përcaktuara në nenin 15 të kësaj Rregulloreje. Grupet mësimore janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor apo atij kërkimor – shkencor të disiplinave që mbulojnë, për realizimin me cilësi dhe në kohë të planeve dhe programeve mësimore në fuqi. Në grupin mësimor shqyrtohen dhe bëhen propozime për dokumentacionin themelor mësimor siç janë programet e lëndëve, programet e praktikave mësimore dhe programet e praktikave të diplomave. Programi i studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, nuk është program i cili i nënshtrohet provimit të shtetit për profesionet e rregulluara. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref 008 - Rregullorja e brendshme e DSHT</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që	GVJ iu komunikua në takimin që pati me përfaqësues të NjSBC se kjo Njësi organizon dy herë në vit sondazhe me studentët për të marrë prej tyre opinione për mbarëvajtjen e procesit mësimor, marrëdhënies me pedagogët e lëndëve, zhvillimin e praktikave mësimore, zhvillimi e orëve laboratorike, etj. Përpunimi i pyetësorë të studentëve bëhet nga kjo Njësi dhe me rezultatet e saj njihen Dekanati i Fakultetit të Gjeologji Minierave, pjesë e të cilit është edhe Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave të Tokës.

përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.				
Konkluzione	GVJ shprehet se Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë, e cila është e organizuar dhe funksionon në rang Institucional monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultate të mira të të nxënit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Për plotësimin e këtij kriteri, GVJ shqyrtoi një sërë dokumentesh të cilat janë në Dosjen e Vetëvlerësimit, dokumente të cilat janë cituar edhe në raportin e vlerësimit të brendshëm të këtij programi. Në mungesë të Ref 002 (Plani strategjik i UPT 2019-2024), i cili është cituar edhe në RVB, por nuk është në DVV, GVJ i është referuar Planit strategjik të DSHT 2018-2023 Në këtë plan strategjik janë të përcaktuara drejtimit, politikat dhe planet e veprimit dhe të menaxhimit të Departamentit të Shkencave të Tokës, zhvillimin në perspektivë në përputhje me zhvillimet e vendit dhe të ekonomisë, prioritetet e zhvillimit dhe objektivat për çdo prioritet. Rëndësia e planit strategjik të DSHT qëndron në vendimmarrjen, planifikimin, përsosjen dhe konsolidimin e menaxhimit institucional, procesit mësimor, formimit akademik dhe punës kërkimore-shkencore, në shkallë vendi, rajoni dhe më gjerë. Sipas këtij plani (pika IV) synohet që Departamenti i Shkencave të Tokës të përmirësojë kulturën e cilësisë në procesin e edukimit, nëpërmjet zbatimit të standardeve më të përparuara, kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky Departament zhvillon dhe zbaton mekanizma për promovimin dhe zotërimin e një kulture të cilësisë në të gjitha njësitë dhe në të gjitha nivelet, zhvillimin e procedurave për monitorimin dhe rishikimin e cilësisë akademike, rritjen e cilësisë në qeverisje dhe menaxhimin e Fakultetit të Gjeologji Minierave, me synim rritjen e cilësisë në të gjitha programet e studimit që ofron. Gjithashtu në këtë plan (pika 4.2.1) synohet akreditimi i programeve të studimit nëpërmjet zhvillimit kurikular cilësor, jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe rajonal, duke plotësuar standardet shtetërore për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit që ofron.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>Referenca</i> <i>Ref 009 - Plani strategjik i DSHT 2018-2023</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ gjatë takimit me GVB iu bë e ditur se si ishte ngritur Grupi i vlerësimit të brendshëm dhe si ishte bërë ndarja e detyrave në anëtarët e këtij grupi. Për pyetjet e ndryshme të adresuara në anëtarët e këtij grupi, GVJ mori përgjigje të qarta dhe koncize. Pasqyrimi ishte i saktë dhe vlen të theksohet që gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm në kuadër të akreditimit të këtij programi studimi, si pikë e fortë u theksua mbështetja e personelit akademik të këtij programi për një proces sa më konkret dhe gjithëpërfshirës. Si pikë e dobët u konfirmuan oraret e zhvillimit të mësimin të studentëve, për shkak të rikonstruksionit të godinës. <i>Referenca:</i> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	GVJ iu komunikua se përbërja e grupit të vlerësimit të brendshëm të programit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, është përcaktuar nga Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave të Tokës (shkresë Nr. 155 Prot., datë 25.03.2024). Në bazë të kësaj shkrese të Departamentit, Dekani i Fakultetit të Gjeologji Minierave ka miratuar përbërjen e GVB me shkresë Nr. 199/1 Prot., datë 26.03.2024. Në përbërje të këtij grupi është edhe një student i programit të studimit. <i>Referenca:</i> <i>Ref 009 - Urdhër i Dekanit të FGJM për ngritjen e GVB</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Bazuar në raportin e vetëvlerësimit, por edhe në takimin e gjatë dhe produktiv që pati GVJ me anëtarët e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm, rezultoi se Fakulteti i Gjeologji Minierave dhe Departamenti i Shkencave të Tokës, ka rregulluar integritetin akademik duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve të tij. <i>Referenca</i> <i>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me	Ashti siç është pohuar edhe në Raportin e vlerësimit të brendshëm, për sigurimin e brendshëm të cilësisë së këtij programi studimi është vepruar njësoj si për vlerësimin në kuadër të akreditimit edhe të programeve të tjera që ofrohen në UPT të cilat kanë përfunduar vlerësimin në kuadër të akreditimit të tyre ose janë në proces akreditimi. Nuk ka ekspertizë të ekspertëve të jashtëm për këtë program studimi.

cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.				
Konkluzione	GVJ plotësimin e këtij standardi shprehet se përgjithësisht në procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë përfshihen anëtarë të personelit akademik të Departamentit, njëkohësisht edhe pedagogë të lëndëve të programit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi. Bëhen përpjekje për të përfshirë edhe studentët, por sugjerojmë që përfshirja e tyre të jetë më aktive. Konfirmojmë pjesëmarrjen e një studenti në GVB së të programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5


Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Rezulton se Institucioni ka hartuar politika të qarta për publikimin e veprimtarive në kuadër të sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Veprimtaritë e tilla bëhen publike dhe dokumentohen në faqen web të UPT. GVJ shprehet se nga këqyrja e faqes web të UPT, shikohet se ka një informacion të plotë për të gjithë strukturat, drejtimin akademik dhe administrativ, programet e studimit, kërkimin shkencor, bashkëpunimet ndërinstitucionale; projekte në UPT, etj. Informacioni është i aksesueshëm nga çdo individ që është interesuar për këtë institucion. <i>Referenca:</i> <i>Faqja web e UPT: https://upt.edu.al/</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në dosjen e vetëvlerësimit Institucioni ka paraqitur raportin e Anketimit studentor të cilin e ka të publikuar dhe në faqen web të UPT Në këtë faqe janë të publikuara raportet mbi anketimin studentor që nga viti 2017-2018 dhe deri në vitin akademik 2019-2020, semestri i dytë. Duhet të punohet më shumë për publikimin dhe përditësimin e të dhënave edhe për vitet e tjera akademike, duke filluar nga viti akademik 2020-2021.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që	GVJ shprehet se nga këqyrja e materialeve që gjenden në DVV, raportet e anketimeve të studentëve, kanë një rubrikë në fund për masat që synohen të arrihen në përmirësim të dobësive të evidentuara nga përgjigjet e studentëve. Konkretisht, në Raportin e anketimit studentor "Cilësia e mësimdhënies online",

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	anketimi i zhvilluar në vitin akademik 2019-2020 (semestri i dytë), në faqen 11, pika 3.5 janë paraqitur rekomandimet dhe propozimet për përmirësimin e treguesve të ulët. Qëllimi i pyetësorit ishte evidentimi i problemeve, mangësive në të gjitha hallkat e mësimdhënies, duke filluar nga niveli universitar dhe deri tek pedagogët e lëndëve. Nisur nga fakti që ky sondazh është bërë në kohën e pandemisë Covid 19, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në këtë Raport shprehet se ndryshe nga sondazhet e tjera të zhvilluara nga kjo drejtori, sondazhi për mësimin online ka nxjerrë në pah problematikat dhe mangësitë që kanë hasur studentët nga përshtatja e mësimin nga auditori në mësimin online. Këtë vështirësi nuk e kanë hasur vetëm studentët por edhe pedagogët e UPT. <i>Referenca:</i> <i>Raport mbi anketimin studentor "Cilësia e mësimdhënies online" Sem. II 2019 – 2020. (raporti gjendet në faqen online të DSBC)</i> https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Për ofrimin e programeve të studimit, efektiviteti i tyre, mundësia e përmirësimit dhe impakti që ka programi tek studentët, GVJ shprehet se UPT ka një bazë rregullatore të konsoliduar, në të cilën janë të përcaktuara qartë mënyrat, ofrimi dhe veprimtaria e programit të studimit. Ashtu siç është paraqitur edhe në raportin e vlerësimit të brendshëm, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për respektimin e standardeve të përgatitjes së të gjithë dokumentacionit që përmban programi i studimit (plani mësimor, syllabuset, ngarkesa e pedagogëve, përputhshmëria e formimit të tyre akademik me lëndën që japin mësim). Në rregulloren e Fakultetit të Gjeologji Minierave, neni 38, flitet për Këshillin e Programit të Studimit (KPS). Ky këshill ngrihet në nivel departamenti dhe është përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e çdo programi studimi. Këshilli analizon çdo propozim ose përmirësim të programit të studimit; harton draft propozimin për programet e reja të studimit që synohen të hapen; përgatit raportin e analizës vjetore të programit të studimit dhe ja përcejell për diskutim dhe miratim departamentit përgjegjës; analizon format e vlerësimit të studentit; etj. <i>Referenca</i> <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ref 006 - Rregullorja e FGJM</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e	GVJ pohon se për gjitha sa jemi shprehur edhe më sipër, në UPT, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, në Departamentin e Shkencave të Tokës, bëhen përpjekje për të informuar studentët dhe stafin akademik për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. Një rol të rëndësishëm luan Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila duhet të marrë masa që të zbatohet sa më shpejt të jetë e mundur edhe thithjen e mendimeve nga personeli



tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	akademik i këtij Departamenti për përditshmërinë, zbatimin dhe implementimin e programit të studimit objekt vlerësimi, BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se ka politika, qasje të mira dhe veprimtari për të bërë të mundur sigurimin e cilësisë në programet e studimit që ofrohen në UPT dhe konkretisht në programin e studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Gjeomjedisi” të ofruar nga Universiteti Politeknik i Tiranës (Fakulteti Gjeologji Miniera).

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, ka stafin e duhur akademik për ofrimin e këtij programi studimi, shumë specifik, një pjesë e konsiderueshme e tyre janë me titull dhe me gradë.
2. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi është i pajisur me personel akademik dhe ndihmës akademik, të cilët posedojnë kualifikimet e nevojshme dhe përvojën profesionale për të kryer aktivitete mësimore dhe orët laboratorike në përputhje me standardet e vendosura profesionale.
3. Programi Bachelor në “Inxhinieri Gjeomjedisi” konsiderohet si program me prioritet kombëtar. Studentët të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e duhura në përputhje me ligjin përfitojnë mbështetje financiare.
4. Universiteti Politeknik i Tiranës ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, aktorë të biznesit, në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.
5. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit akademik dhe është e përafërt me programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndarja e veprimtarive formuese ka një raport teori/praktikë të ekuilibruar, gjë që krijon mundësi për formim të plotë të studentit për arritjen e objektivave.

6. Institucioni mbështet stafin e tij akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike, si dhe inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe Workshop-e me profesor të ftuar nga universitete të ndryshme.
7. Institucioni mbështet financiarisht trajnimin e stafit akademik në universitetet homologe jashtë vendit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në kuadër të përmirësimit të cilësisë.

Pika të dobëta:

1. Konstatohet se të gjithë pedagogët e DSHT kanë realizuar mbingarkesë, e cila lidhet me daljen në pension ose largimin nga puna të disa pedagogëve efektivë të departamentit dhe mos zëvendësimin e tyre me të rinj.
2. Numri i ulët i studentëve që bëhen pjesë e këtyre mobiliteteve, për shkak të nivelit të dobët të njohjes së gjuhës angleze. [(Standard II.1/Kriteri 8)]
3. Programi i studimit është i ngjashëm në masën 70% me programe të ngjashme studimi të ofruara nga institucione të tjera në vend. Përkatësisht, vetë Universiteti Politeknik ofron programin Bachelor në "Inxhinieri Mjedisi" në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, kurrikula e të cilit është pothuajse e ngjashme me këtë program. [(Standard II.1/Kriteri 6)]
4. Nga vizita në Institucion nuk e patëm të mundur të shikonim Laboratorët apo mjediset e tjera në ndihmë të mësimdhënies. Aparaturat dhe mjetet e nevojshme të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi nuk ishin plotësisht në funksion ose ishin të ambalazuara, për shkak të rikonstruksionit të godinës së FGJM. Po kështu, edhe biblioteka fizike nuk ishte në dispozicion. [(Standard II.3/Kriteri 2)]
5. Pjesëmarrja e studenteve në anketim është 70-80% në rang Universiteti, ndërsa në rang Fakulteti është vetëm 5%. [(Standard II.5/Kriteri 2)]
6. Nuk realizohet anketimi i stafit në kuadër të sigurimit brendshëm të cilësisë.
7. Nuk përcaktohen pikët për kriteret e punësimit për personelin akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Pikësimi bëhet subjektiv nga anëtarët e komisionit, pasi nuk janë përcaktuar raporti i pikëve të intervistës me gojë me dosjen e dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesit. [(Standard IV.1/Kriteri 4)]

Rekomandime:

1. Për një efikasitet më të mirë të punës së pedagogëve të Departamentit të Shkencave të Tokës por edhe të stafit të programit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, njësia kryesore duhet të marrë masa para fillimit të vitit të ri akademik, që të plotësojë vendet vakante të stafit akademik, në mënyrë që të shmangë mbingarkesën e stafit ekzistues.
2. Për të rritur cilësinë e mësimdhënies, rekomandojmë institucionin që të pajisë profesorët me projektor apo me mjete të tjera teknologjike për të zhvilluar mësim sa më bashkëkohor, deri në përfundim të rikonstruksionit të godinës së FGJM.

3. Mendojmë që për të rritur cilësinë, si edhe për të përmirësuar metodat e mësimdhënies duhen motivuar studentët për t'u bërë pjesë në këtë proces dhe duhen reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre sa më saktë.
4. Vlerësojmë që forma e punësimit për pedagogët full time dhe part time në UPT të jetë më transparente. Çdo kriter duhet të jetë i përcaktuar qartë me pikët përkatëse. Gjithashtu, duhet të përcaktohen pikët për intervistën me gojë (ose % që zë intervista me gojë, kundrejt dosjes me dokumente)
5. Rekomandojmë që DSHT duhet të përgatisë një plan financiar për programin e studimit BSc në Inxhinieri Gjeomjedisi, në të cilin të përfshihen financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in "Geoenvironmental Engineering" provided by the "Polytechnic University of Tirana (Faculty of Geology and Mining)".

Strengths and affirmations

1. Polytechnic University of Tirana, Faculty of Geology and Mines, has the appropriate academic staff for the provision of this very specific study program. A considerable number of them have academic titles and scientific degrees.
2. The Bachelor's study program in Geoenvironmental Engineering is provided with academic and non-academic staff, that possess the necessary qualifications and professional experience to carry out teaching activities and laboratory hours in accordance with established professional standards.
3. The Bachelor program in Geoenvironmental Engineering is considered a national priority program. Students who meet the right conditions and criteria in accordance with the law can receive financial support.
4. Polytechnic University of Tirana has established cooperation relations with institutions, companies, business actors, in function of the implementation of the study program, in the framework of vocational training, scientific research and mobility.
5. The structure of the program is created based on the experience of academic staff and is approximate to similar national and international programs. The division of the formative activities has a balanced theory/practice ratio, which creates opportunities for comprehensive education of the students for achieving the program objectives.



6. The Institution supports its academic staff to improve didactic competences, as well as encourages and motivates academic staff to further improve teaching by organizing various training activities, open lectures and Workshops with professors invited from different universities.
7. The institution financially supports the training of academic staff at counterpart universities abroad to continuously improve teaching in the framework of quality improvement.

Weaknesses

1. All academic staff of the Department of Soil Sciences are overloaded, which is related to the retirement or dismissal of some effective professors of the department and not replacing them with young staff.
2. The low number of students who become part of the mobility programs due to the poor level of English language. [(Standard II.1/Criterion)]
3. The study program is about 70% similar to other study programs offered by other institutions in the country. Namely, the Polytechnic University itself offers the Bachelor program in "Environmental Engineering" at the Faculty of Civil Engineering, whose curriculum is almost similar to this program. [(Standard II.1/Criterion 6)]
4. As highlighted during the institutional visit, the evaluation team was not able to see laboratories or other supporting facilities. The necessary equipment and tools suitable for the implementation of learning modules, theoretical and practical training and the formative objectives of the study program were not fully functioning or were packed, due to the reconstruction of the faculty building. The physical library was not available as well. [(Standard II.3/Criterion 2)]
5. The student participation in the survey is 70-80% at the University level, while only 5% at the faculty level. [(Standard II.5/Criterion 2)]
6. No staff survey in the framework of internal quality assurance is carried out.
7. No scores are determined for employment criteria for effective and part-time academic staff. Scores are subjectively assigned by the members of the Selecting Commission, as the report of oral interview points versus the documentation submitted by the applicants is not determined. [(Standard IV.1/Criterion 4)]

Recommendation

1. In order to ensure better efficiency of the academic staff of the Department of Soil Sciences, particularly those who contribute to the Bachelor study program on Geoenvironmental engineering, it is necessary that the Department takes appropriate measures to complete the vacant positions to avoid overloading the existing staff
2. To increase the quality of teaching, we recommend the institution to equip professors with appropriate IT equipment (projectors, etc) to provide contemporary learning experiences, until the completion of the reconstruction of the faculty building.

3. To ensure the long-term quality of the stay programs it is of paramount importance to motivate students to participate in surveys and reflect their thoughts and suggestions as accurately as possible.
4. The process of selection of full time and part time staff at Polytechnic University of Tirana need to be more transparent. Selection criteria must be clearly defined, and specific scores assigned. Also, scores for oral interview and the ratio between interview scores and document assessment scores should be set.

The Department of Soil Sciences should prepare a financial plan for the BSc study program in Geoenvironmental Engineering, which includes adequate financing of human resources needed for effective delivery of the program as well as operational expenses for maintenance of facilities and supporting technologies of the learning process, expenditures for library and enrichment of literature and access to online libraries, financial obligations, domestic or foreign grants obtained and services contracts concluded in order to implement study programs, projects and other budget lines.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit:

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X



